



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.  
\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

Tiranë, më

**VENDIM**

**Nr. 52, datë 12.02.2021**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM  
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**



•  
•  
•  
•  
•  
•

---

---

## **BURIMET E VLERËSIMIT DHE EVIDENTIMI I TË DHËNAVE QË REZULTOJNË PREJ TYRE**

---

---

Në këtë pjesë të raportit të vlerësimit gjenden të listuara burimet e vlerësimit si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur dhe vetëm për aq sa është e nevojshme për këtë proces vlerësimi, të dhënat që rezultojnë nga aktet e dokumentet e përdorura në procesin e rivlerësimit kalimtar si dhe ato të marra rishtazi. Raporti i analizimit të aftësive profesionale të gjyqtarit përgatitur nga organi kompetent në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, duke qenë një akt që përshkruan të dhënat e burimeve të vlerësimit dhe analizon gjetjet që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre, konsiderohet, për efekt gradimi i barasvlershëm me raportin analitik, vetëm për burimet në të cilat ai referon.

Burimet e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi nën periudhën e vlerësimit 2012

POLI I DREJTËSISË

RRUGA "ANA KOMNENA"

TIRANË

⋮

**Grupi I : Aktet dhe dokumentet e përdorura në vlerësimin e aftësive profesionale nga organet e rivlerësimit të listuara si më poshtë:**

- 1. Formulari i vetë deklarimit të gjyqtarit** i cili administrohet në dosjen e rivlerësimit<sup>1</sup> dhe është përshkruar dhe analizuar në mënyrë të plotë si burim vlerësimi në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit {...} me nr. 3120/4 prot, datë 17.07.2019<sup>2</sup>.
- 2. Të dhënat e dosjes personale të gjyqtarit** e cila është administruar gjatë përgatitjes së Raportit për analizimin e aftësive profesionale me nr. 3120/4 prot, datë 17.07.2019 procesit të rivlerësimit duke u analizuar si burim vlerësimi në këtë raport.
- 3. Të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit<sup>3</sup>;**

Referuar të dhënave statistikore për periudhën e vlerësimit Tetor 2013-Tetor 2016, administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se :

Gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Gjatë kësaj periudhe, rezultojnë të dhënat statistikore si më poshtë, për çdo vit kalendarik:

Për vitin 2013 (7.10.2013-31.12.2013), ka përfunduar gjithsej 6 çështje nga të cilat 1 penale themeli, 3 masa sigurimi dhe 2 kërkesa penale.

Për vitin 2014 (1.1.2014-31.12.2014), ka përfunduar 59 çështje nga të cilat 12 penale themeli, 3 kërkesa për sekuestro parandaluese, 33 masa sigurimi dhe 11 kërkesa penale.

Për vitin 2015 (1.1.2015-31.12.2015), ka përfunduar 67 çështje nga të cilat 12 themeli, 2 kërkesa për sekuestro parandaluese, 1 kërkesë për konfiskim pasurie, 42 masa sigurimi dhe 11 kërkesa penale.

Për vitin 2016 (1.1.2016-7.10.2016) ka përfunduar 40 çështje, nga të cilat 10 penale themeli, 1 kërkesë për konfiskim pasurie, 5 masa sigurimi dhe 14 kërkesa penale.

- 5. Dosjet e përzgjedhura me short në procesin e rivlerësimit kalimtar (5 dosje),** të përshkruara në mënyrë të detajuar në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Këshillit të Lartë Gjyqësor<sup>4</sup>, si më poshtë:

**Dosja 1** - Çështja penale me nr. 92 regjistri, datë regjistrimi 2.5.2014, ndaj të pandehurit Mirçea Hysenllari, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a/2 dhe 22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 72, datë 19.6.2014.

<sup>1</sup> Faqe 4 deri 14 e dosjes së rivlerësimit;

<sup>2</sup> Faqe 584-615 e dosjes së rivlerësimit;

<sup>3</sup> Të dhëna statistikore të administruara në faqet 94-98 të dosjes së rivlerësimit.

<sup>4</sup> Faqe 6 - 11 të Raportit, faqe 289-594 të dosjes së rivlerësimit;

⋮  
**Dosja 2** - Çështja penale me nr. 144 regjistri, datë regjistrimi 23.7.2014, ndaj të pandehurit Lutfi Balloshiti, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a/1 dhe 22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 113, datë 2.10.2014.

**Dosja 3** - Çështja penale me nr. 132 regjistri, datë regjistrimi 24.6.2015, ndaj të pandehurit Isuf Bruçi, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, parashikuar nga neni 109/b/1 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 92, datë 25.9.2015.

**Dosja 4** - Çështja penale me nr. 85 regjistri, datë regjistrimi 19.1.2016, ndaj të pandehurës Dituri Meni, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”, parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 49, datë 12.4.2016.

**Dosja 5** - Çështja penale me nr. 430 regjistri, datë regjistrimi 15.10.2015, me objekt ekzekutim mase sigurimi për shtetasin Alfred Proko bazuar në nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale, përfunduar me vendimin nr. 430, datë 15.10.2015.

#### **6. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim<sup>5</sup> si më poshtë:**

**Vendimi 1** - Vendimi nr. 18, datë 10.2.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me nr. regjistri 25/172, datë regjistrimi 10.11.2014, ndaj të pandehurit Musli Mehmetaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhje e bankave” në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Grup i strukturuar kriminal”, “Mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 136/2, 28/4, 333 germa “a”, dhe 278/2 të Kodit Penal.

**Vendimi 2** - Vendimi nr. 73, datë 10.6.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me nr. regjistri 64/214, datë regjistrimi 31.12.2014, ndaj të pandehurit Xhevair Osja, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i të miturve”, parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal.

**Vendimi 3** - Vendimi nr. 4, datë 8.4.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me datë regjistrimi 20.7.2015, me kërkesë Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, palë e tretë shtetasi Eric Nyssens Marie Felix, me objekt “Konfiskimin e llogarisë me nr. 0000986135 në Bankën Raiffeisen Bank”, me bazë ligjore Ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

#### **6. Vendime të administruara për shkak të ankesave ose kryesisht nga organet e rivlerësimit që i përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016.**

Në dosjen e dërguar nga organet e rivlerësimit, e cila përmban aktet e vlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton të jenë administruar vendime gjyqësore të gjyqtarit {...}, për shkak të

---

<sup>5</sup>Vendimet e paraqitura nga gjyqtari së bashku me formularin e vetë deklarimit për aftësitë profesionale janë administruar në dosjen e rivlerësimit dhe janë përshkruar në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të përgatitur nga KLGJ, faqe 4 deri 7 e Raportit, faqe 605-608 e dosjes së rivlerësimit.

aneksave të publikut apo të marra kryesisht nga organet e rivlerësimit kalimtar, të cilat i përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016.

Në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me denoncimet nga publiku, parashtrohet se: *“Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë depozituar 6 denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, z. {...}. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale verifikoi dhe analizoi me objektivitet të gjitha denoncimet e depozituara. Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional. Nga shqyrtimi në tërësi i këtyre denoncimeve duket se nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe me figurën e subjektit të rivlerësimit.”*<sup>6</sup>

## **7. Të dhëna nga burimet arkivore të KLD/KLGJ;**

Referuar Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr. 3120/4 prot, datë 17.7.2019, rezulton se: *“Sipas të dhënave nga regjistri i aneksave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit për gjyqtarin {...} janë paraqitur **tre ankesa** të Inspektoratit e KLD-së. Dy ankesa të vitit 2014, verifikuar bazuar në raportin periodik të vetë kryetarit në lidhje me vendimet e cenuara i janë regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik. Një ankesë e vitit 2015, verifikuar për mosrespektim formal të ligjit është në verifikim në vijim. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.”*

**Në lidhje me tre ankesat për të cilat referon Raporti si më sipër, në aktet e dosjes së rivlerësimit nuk rezulton të jenë administruar të dhënat e plota për trajtimin e tyre.** Për këtë arsye, është kërkuar nga arkiva e KLGJ-së, informacion dhe dokumentacion lidhur me trajtimin e aneksave dhe është administruar kopje e relacioneve të Inspektoratit të KLD-së lidhur me përfundimin e verifikimeve përkatëse si dhe urdhrat/vendimet për përfundimin e verifikimit të aneksave, akte të cilat janë bërë pjesë e dosjes së vlerësimit të gjyqtarit. Nga përmbajtja e dokumentacionit për verifikimin dhe trajtimin e aneksave, rezulton si më poshtë:

**Materiali 1** – Me relacionin e datës 3.10.2016 të Inspektoratit, miratuar nga Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë më datë 16.12.2016, është trajtuar materiali i ardhur nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe Gjykata e Lartë, lidhur me cenimin e disa vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, bazuar në urdhrin e verifikimit me nr. 3419/5 prot, datë 02.06.2014.

Një ndër vendimet e trajtuara është vendimi nr. 69, datë 14.11.2012 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët {...} (kryesues), Sandër Simoni, Nertina Kosova, Iliriana Olldashi dhe Luan Hasneziri (anëtarë). Në këtë vendim gjykata ka rrëzuar kërkesën e të dënuarit për revokim të dënimit me gjobë Gjykata e Apelit për Krime të

<sup>6</sup>Vendimi i KPK nr. 218, datë 10.12.2019, faqe 40;

.....  
Rënda me vendimin nr. 1, datë 7.1.2013, duke interpretuar parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 69, datë 14.11.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda duke pranuar kërkesën e të dënuarit dhe duke revokuar vendimin e dënimit të tij me gjobë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 450, datë 03.04.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Në raportin e Inspektoratit të KLD, pasi analizohet situata e faktit dhe e ligjit, konkludohet se :”...2. *Cenimi i vendimit nr.69, datë 14.11.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda duhet të mbahet në konsideratë gjyqtarëve : {...}, Sandër Simoni, Nertina Kosova, Iliriana Olldashi dhe Luan Hasneziri, për efekt të vlerësimit etiko profesional të tyre së bashku me analizën e mësipërme.*”.

Vendimi i cili ka qenë objekt verifikimi nëpërmjet raportit si më sipër, mban datën 14.11.2012 dhe si i tillë, nuk bën pjesë në periudhën e vlerësimit 2013- 2016. Por edhe nëse ky vendim do t'i përkiste periudhës së vlerësimit, në Ligjin nr.96/2016 dhe aktet nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit, përqindja e vendimeve të cënuara nga gjykatat më të larta në kuadër të shqyrtimit të ankimit të palëve, nuk përbën një tregues për efekt të vlerësimit profesional të gjyqtarit.

**Materiali 2** – Me relacionin e datës 16.12.2014 të Inspektoratit të KLD-së, miratuar nga Zëvendëskryetari me datë 30.12.2014, është verifikuar dhe trajtuar informacioni i ardhur nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda lidhur me cenimin e disa vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, bazuar në urdhrin e verifikimit nr.2498/2 prot, datë 26.11.2014. Një ndër vendimet e trajtuara në procedurën e verifikimit është vendimi nr. 40, datë 24.03.2014 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Sandër Simoni (kryesues), Dritan Hallunaj, Fran Prendi, Nertina Kosova dhe {...} (anëtarë). Në këtë vendim gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor dhe dënimin e të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr. 48, datë 15.05.2014 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë përsa i përket cilësimit ligjor dhe deklarinimit fajtor të të pandehurit duke ndryshuar vendimin për pjesën tjetër, duke dënuar të pandehurin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 në lidhje me nenin 22 dhe 23/2 të Kodit Penal, dhe uljen e dënimit për shkak të aplikimit të nenit 406 të K.Pr.P. Palët kanë ushtrua rekurs dhe deri në momentin e hartimit të relacionit nga Inspektorati nuk rezulton të ketë pasur një vendimarrje të Gjykatës së Lartë.

Rezulton se shkak i ndryshimit të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nga Gjykata e Apelit ka qenë mospranimi prej saj i kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, kërkesë e cila është vlerësuar e drejtë nga Gjykata e Apelit. Në lidhje me faktin objekt verifikimi, në Raportin e Inspektoratit, pasi parashtrihen pjesë të arsyetimit të vendimit të të dy gjykatave, vlerësohet se :”...*Mospranimi i kësaj kërkesë nga gjykata e shkallës së parë nuk përbën shkelje të vendimit unifikues, për sa kohë që gjykata ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhjen në gjendjen që ishin aktet, duke marrë edhe shpjegime dhe prova kryesisht si pyetja e dëshmitarit, kryerja e ekspertimit tahografik, referuar neneve 366,367 dhe 178 të K.Pr.P.*

ndërkohë që gjykata e apelit vlerëson të kundërtën se marrja e këtyre provave, administrimi i të cilave nuk ka ndikuar mbi akuzën dhe aktet e vlefshme në funksion të provueshmërisë së saj, të cilat ishin pranuar edhe nga i pandehuri Berhami, mohimi i të drejtës për të proceduar sipas rritit të gjykimit të shkurtuar dhe në tërësi përfitimi ligjor i procesit duke përfshirë këtu ekonominë gjyqësore, vijnë në vazhden e mosrespektimit të të drejtave dhe garancive ligjore që ligji procedural penal i ka njohur të pandehurit në procesin penal, pra nuk është shkak për të rrëzuar kërkesën për gjykim të shkurtuar. Për sa sipër, çmohet se nuk ka shkelje të vendimit unifikues nr.2/2003 nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe fakti që Gjykata Kushtetuese i ka dhënë të drejtë Gjykatës së Apelit të shqyrtojë vendimin e rrëzimit të kësaj kërkesë, kjo jo domosdoshmërisht do të thotë se është shkelur vendimi unifikues, pasi pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar është më tepër atribut i vlerësimit të gjykatës dhe vendimi unifikues nuk ka përcaktuar rastet kur pranohet ose jo por e ka lënë të hapur interpretimin nga vetë gjykata rast pas rasti, kur vlerësohet prej tyre se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet dhe që shërben për ekonomi gjyqësore, pra kur hetimi është i plotë dhe nuk ka dyshime rreth provave, fajësisë apo pafajësisë së të pandehurit. Në këto kushte vendimi i cenuar t'u mbahet në konsideratë gjyqtarëve për efekt të vlerësimit të tyre profesional dhe etik...Për sa më sipër, konkludohet se:....c) Cënimi i vendimit nr. 40, datë 24.03.2014 ti evidentohet gjyqtarëve Sandër Simoni, Dritan Hallunaj, Fran Prendi, Nertina Kosova, {...} për efekt të vlerësimit profesional dhe etik të tyre.”.

Vendimi i cili ka qenë objekt verifikimi nëpërmjet raportit si më sipër, mban datën 24.03.2014 dhe si i tillë, bën pjesë në periudhën e vlerësimit 2013-2016. Pavarësisht se relacioni i datës 16.12.2014 i Inspektoratit të KLD-së, nuk bën pjesë në dosjen e dërguar nga organet e rivlerësimit, ai përbën burim vlerësimi për efekt të procesit të gradimit, në zbatim të nenit 77 shkronja “dh” të Ligjit “Për Statusin”, sipas të cilit, të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit, konsiderohen burim vlerësimi.

Ky burim vlerësimi referon vetëm në faktin e cënimit të vendimit nga një gjykatë më e lartë dhe si i tillë merrej parasysh në vlerësim, sipas parashikimeve të nenit 23 pika 1 shkronja “c” të Vendimit Nr. 261/2 dt. 14.04.2010 të ish/KLD “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”. Por ndryshe nga burimet e sistemit të mëparshëm të vlerësimit, Skema e re e Vlerësimit të Gjyqtarëve, e cila zbatohet në rastin konkret, nuk i parashikon si burim më vete vlerësimi, vendimet e cënuara nga gjykatat më të larta. Skema e Re e Vlerësimit ruan pavarësinë e gjyqtarit, prandaj vetëm përqindja e vendimeve të cënuara nga gjykata më e lartë, nuk përbën tregues për efekt të vlerësimit të aftësive profesionale në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

**Materiali 3** – Me relacionin e datës 23.10.2017 të Inspektoratit të KLD, është verifikuar dhe trajtuar ankesa e ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme me nr. 1313 prot, datë 14.04.2015, për mosrespektim formal të ligjit ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndër të cilët edhe gjyqtari {...}, në lidhje me vendimin nr. 52, datë 03.04.2015.

Me vendimin nr.52, datë 03.04.2015 Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Dritan Hallunaj (kryesues), Ardit Mustafa, Fran Prendi, Liljana Baku dhe {...} (anëtarë), ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit A.F, akuzuar për



.....  
kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 79/c në lidhje me nenin 25 dhe 278/2 të Kodit Penal duke hequr masën e sigurimit personal “Arrest në burg”. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda e vendimin nr. 73, datë 29.06.2015 ka vendosur ndryshimin e vendimit duke deklaruar fajtor të pandehurin A.F për veprat penale të parashikuara nga nenet 79 shkronja “c” dhe 178/2 të Kodit Penal duke e dënuar atë, në bashkim të dënimeve, me burgim të përjetshëm. Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2017-443, datë 08.06.2017 ka vendosur mospranimin e rekursit.

Në lidhje me faktin objekt verifikimi, në Raportin e Inspektoratit, pasi parashtrohen shkaqet e ankesës së paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm dhe shkaqet e ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë nga gjykata e apelit, vlerësohet se: ”.....*në drejtim të zgjidhjes së çështjes në themel nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pretendimet e parashtruara nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm deri në këtë fazë të gjykimit të çështjes janë të bazuara. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda i ka dhënë një zgjidhje të kundërt çështjes nga ajo e shkallës së parë. Nga përmbajtja e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, nuk konstatohen shkelje nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda të normave procedurale apo mosarsyetim të vendimit gjyqësor sikurse pretendohet në ankesën e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Pra, shkeljet e konstatuara nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda lidhen vetëm me mënyrën e vlerësimit të provave nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, vetëm për zgjidhjen e çështjes në themel. Shkeljet e kryera nga gjyqtarët Dritan Hallunaj, {...}, Fran Prendi, Ardit Mustafaj dhe Liljana Baku nuk hyjnë në kategorinë e shkeljeve të disiplinës të parashikuara nga ligji i kohës në fuqi kur u dha vendimi, ligji nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 32 i tij. Shkeljet e konstatuara nga gjyqtarët e mësipërm, të kryera nëpërmjet vendimit gjyqësor nr.52, datë 03.04.2015, të cenuar nga gjykata më e lartë mbahen parasysht vetëm gjatë vlerësimit të tyre profesional....Sa më sipër, për gjyqtarët Dritan Hallunaj, {...}, Fran Prendi, Ardit Mustafaj dhe Liljana Baku, konkludohet se : 1. Arkivimi i ankesës së Prokurorit të Përgjithshëm ndaj veprimtarisë së gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Dritan Hallunaj, {...}, Fran Prendi, Ardit Mustafaj dhe Liljana Baku, dhe mbajtjen parasysht për efekt të vlerësimit profesional të tyre të shkeljeve ligjore të konstatuara nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, dhe që lidhen me vendimin penal nr.52, datë 03.04.2015.. ”.*

Relacioni me datë 23.10.2017 është miratuar nga Kryetari i KLD-së më datë 08.11.2017 dhe më datë 12.12.2017, me urdhër nr. 1313 prot, të Kryeinspektorit është urdhëruar *arkivimi i ankesës dhe kthimin e përgjigjes Prokurorisë së Përgjithshme ndaj gjyqtarëve Dritan Hallunaj, Ardit Mustafa, Fran Prendi, Liljana Baku dhe {...}, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.*

Vendimi i cili ka qenë objekt verifikimi nëpërmjet raportit si më sipër, mban datën 03.04.2015 dhe si i tillë, bën pjesë në periudhën e vlerësimit 2013- 2016. Duke iu referuar përmbajtjes dhe konkluzioneve të relacionit, rezulton se nuk janë konstatuar shkelje procedurale në vendimmarrjen e gjykatës, pjesë e së cilës, në cilësinë e anëtarit është edhe gjyqtari {...}.

Konstatimi i shkeljes në drejtim të zgjidhjes në themel të çështjes, për shkak të qëndrimit të ndryshëm të mbajtur nga gjykata më e lartë në lidhje me vlerësimin e provave dhe fajësinë e të

.....  
pandehurit, dhe referimi për t'u mbajtur në konsideratë në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, bazuar në Ligjin nr.96/2016 dhe aktet nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit, nuk përbën një tregues për efekt të vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit. Konkretisht në nenin 72, pika 4 të ligjit nr.96/2016, parashikohet se: "Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.". Gjykimi mbi mënyrën e çmuarjes dhe vlerësimit të provave si dhe bazueshmërinë e vendimit gjyqësor, përbëjnë gjykim mbi korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, elementë të cilët nuk janë objekt i kontrollit për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit dhe, për këtë arsye, nuk mund të vlerësohen në kuadër të këtij procesi.

Sa më sipër, për periudhën e vlerësimit 2013- 2016, gjatë së cilës ka filluar dhe përfunduar verifikimi nga Inspektorati i KLD-së për ankesën e parashtruar në materialin 1 në të cilën gjyqtari ka pasur rolin e kryesuesit, si dhe gjatë së cilës ka përfunduar gjykimi i 2 çështjeve të tjera të parashtruara në materialin 2 dhe 3, çështje ne të cilat gjyqtari ka pasur rolin e anëtarit të trupit gjykues, nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe analizuar në relacionet përkatëse, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cënimit të etikës apo që mund të përdoren për vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit.

Referuar akteve të dosjes së rivlerësimit si dhe dosjes personale të gjyqtarit {...}, nuk rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, të jetë dhënë apo zbatuar masë disiplinore ndaj tij.

## **8. Të dhëna për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese në periudhën e vlerësimit.**

Referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr. 398/1 prot datë 13.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se gjyqtari është angazhuar në aktivitete trajnuese si me poshtë:

- Në cilësinë e ekspertit në Programin e Formimit Vazhdues në 4 aktivitete trajnuese të zhvilluara në datat 26 maj 2014, 16 dhe 17 prill 2015, 10 dhe 11 dhjetor 2015 dhe 14 dhe 15 prill 2016;
- Në cilësinë e lehtësuesit në Programin e Formimit Vazhdues në 1 aktivitet trajnues të zhvilluar në datat 13 dhe 14 prill 2016;
- Në cilësinë e pjesëmarrësit në Programin e Formimit Vazhdues në 20 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 33 ditë trajnimi;

Ka marrë pjesë në dy aktivitete profesionale, jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës si më poshtë:

- Konferenca shkencore ndërkombëtare "Forcimi i institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë", organizuar nga OSBE, më datë 24 qershor 2014, ku gjyqtari ka marrë pjesë dhe referuar;
- Aktiviteti me temë "Gjykimi i çështjeve të terrorizmit dhe sigurisë kombëtare", organizuar nga CEELI në Pragë, Çeki, në datat 15-14 qershor 2016;

## **9. Raport për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit {...} me nr. 3120/4 prot, datë 17.7.2019, faqe 584-615 e dosjes së rivlerësimit. Pjesa**

.....  
përshkruese dhe analiza e gjetjeve në këtë akt nuk përsëriten në raportin e vlerësimit. Për çdo element të nevojshëm të analizës dhe vlerësimit, raporti i vlerësimit referon drejtpërdrejt në përmbajtjen e Raportit përkatës.

## **10. Vendimi nr. 218, datë 10.12.2019 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit<sup>7</sup>.**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi ka parashtruar dhe analizuar burimet e vlerësimit në lidhje me aftësitë profesionale të gjyqtarit<sup>8</sup>, ka konkluduar lidhur me këtë kriter vlerësimi si vijon: “...Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: i. raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga Inspektorati i KLD-së dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij; ii. vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; iii. kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij). Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur 3 dokumentet ligjore të paraqitura, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short si edhe të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pas verifikimit të raportit Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional. Komisioni, në tërësi, vërejtë se subjekti i rivlerësimit ndalet për të identifikuar kërkimet e organit të prokurorisë dhe prapësimet e mbrojtjes, i analizon ato në raport me provat e paraqitura dhe konkludon për faktin penal, si dhe masën e dënimit që duhet caktuar. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, duke i bërë ato pjesë të vendimeve gjyqësore. Përdorimi i referencave në jurisprudencën e mëparshme gjyqësore bëhet rregullisht nëpër vendime apo në dhënien e vendimeve të ndërprerë, konstatohet referenca tek vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë sikurse është rasti i vendimit unifikues nr. 03/2011, lidhur me ardhjen e pasojës, e cila është e ndërprerë për shkaqe të paparashikuara nga vullneti i të pandehurit, apo vendimi tjetër unifikues nr. 02/2003 i Gjykatës së Lartë për gjykimin e shkurtuar (shih dosjet nr. 1, 2 dhe 4). Komisioni konstaton se, në tre dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se gjyqtari {...} identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e çështjeve. Gjyqtari {...}, ka njohuri shumë të mira të së drejtës penale për ato vepra penale që përfshihen në kompetencën lëndore të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Bën lidhjen e pjesës së përgjithshme me atë të posaçme të Kodit Penal, duke identifikuar rastin kur vepra penale nuk është përfunduar, është ndërprerë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe masa e dënimit nga Gjykata e Krimeve të Rënda është caktuar në kufijtë minimal që parashikon dispozita penale konkrete (shih dosjet nr. 1 dhe 2), si dhe njeh kriteret e individualizimit të masave të dënimit (shih dokumentet nr. 1 dhe 2). Gjithashtu, ai njeh dhe zbaton drejt procedurën e gjykimin të shkurtuar (shih dokumentet nr. 1 dhe dosjet nr. 1, 2, 3 dhe 4). Konstatohet se subjekti respekton etikën në punë dhe integritetin profesional, si dhe ka treguar gatishmëri për t’u angazhuar në aktivitete profesionale. Gjithashtu, ka pjesëmarrje si ekspert e lehtësues në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në periudhën maj 2014 – aktualisht.....Për sa më sipër, pasi u hetua, analizua dhe u vlerësua raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni

<sup>7</sup> Vendimi nr. 218, datë 10.12.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka marrë formë të prerë për shkak të mosankimit më datë 18.03.2020, faqe 38-40.

<sup>8</sup> Vendimi i KPK nr. 2018, datë 10.12.2019, faqe 38-40.

...

arrin në konkluzionin se nuk ka indice apo elemente nga të cilat të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit. Nga vlerësimi tërësor i aftësive profesionale në përfundim Komisioni e ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit, z. {...}, “të aftë” në detyrën e gjyqtarit..”

Ndërkohë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, lidhur me kriterin e pasurisë, konkludon se: “Në përfundim, Komisioni vlerëson se: i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorim të tij. iii. Pasaktësia e konstatuar në deklarinim më sipër si dhe masa e konstatuar në mungesën e burimeve të ligjshme, nuk është në atë shkallë sa të përbëjnë shkak për shkarkim sipas pikës 3, të nenit 61, dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut të drejtësia. iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. {...}, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.<sup>9</sup>”.

## **Grupi II : Çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështje themeli me palë kundërshtare) si më poshtë:**

**Dosja 6<sup>10</sup> (1) - Çështja penale me nr. 105 regjistri, datë regjistrimi 5.6.2014, ndaj të pandehurit Xhevdet Haziri, akuzuar për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve” mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/1-22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 83, datë 8.7.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.** Çështja është regjistruar në datë 5.6.2014 dhe me shortin e datës 10.6.2014 i është caktuar gjyqtarit {...} në cilësinë e kryesuesit. Më urdhrin e datës 10.6.2014 është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

Me vendimin e datës 11.6.2014, 1 ditë pas caktimi me short, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 26.6.2014 dhe urdhëruar njoftimin e palëve (Prokurori, i pandehuri, mbrojtësit e të pandehurit).

Janë zhvilluar gjithsej **3 seanca gjyqësore**, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio të seancave si dhe pasqyrohen në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Në seancën e parë të datës 26.6.2014, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, vijohet me legjitimimin e mbrojtësit të të pandehurit, janë dëgjuar kërkesat paraprake të palëve. Seanca është shtyrë pas pranimit të kërkesës së prokurores për tu njohur me aktet (Prokurori nuk ka qenë prokurori i çështjes por një prokuror i caktuar me autorizim, administruar në dosje). Në po këtë seancë mbrojtësi i të pandehurit ka paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar, e cila nuk është shqyrtuar në këtë seancë për shkak të ndërprerjes së gjykimin për arsye të mësipërme.

<sup>9</sup>Po aty, faqe 36.

<sup>10</sup> Dosjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit, numërtohen në vijim të 5 dosjeve të përzgjedhura për procedurën e rivlerësimit kalimtar, vetëm për efekt referimi të tyre në raport.

Seanca e dytë e datës 1.7.2014, është zhvilluar në prezencë të të gjithë palëve dhe mbrojtësve, duke ndjekur hapat proceduralë të parashikuara nga neni 405 i K.Pr.P, për shkak të kërkesës së të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar kërkesë e cila, pasi i është marrë mendim prokurorit, është pranuar nga gjykata me vendim të ndërmjetëm, duke pasqyruar dhe arsyen e pranimi të saj si dhe duke referuar në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 2, datë 29.1.2003. Në procesverbal citohen edhe aktet të cilat bëhen për herë të parë pjesë e fashikullit të gjyimit, për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar (*deklarimet e marra gjatë hetimeve paraprake*) të cilat janë administruar në dosjen gjyqësore. Seanca është ndërprerë në fazën e diskutimit përfundimtar të palëve, duke pranuar kërkesën e tyre për ti dhënë kohë për paraqitjen e diskutimit me shkrim. Në vendimin për shtyrjen e seancës pasqyrohet arsyet e shtyrjes së seancës si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*marrja dijani e palëve prezent dhe urdhërimi për shoqërimin e të pandehurit*).

Seanca e tretë e datës 8.7.2014, është zhvilluar në prezencë të palëve. Në këtë seancë prokurori dhe mbrojtësi kanë paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim, të cilat administrohen në dosje. Pasi i jepet fjala të pandehurit për të parashtruar kërkimin përfundimtar drejtuar gjykatës, dhe me pas prokurorit për të bërë replikë, në bazë të nenit 378 të K.Pr.P është deklaruar i mbyllur shqyrtimi gjyqësor dhe gjykata, pasi tërhiqet në dhomë këshillimi, në kthim, ka shpallur vendimin përfundimtar për deklarimin fajtor të të pandehurit.

Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar duke respektuar afatin 15 ditor të shtyrjes të parashikuar në nenin 342/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe rezultojnë të jenë shtyrë për shkaqe të përligjura (*dhënia kohë prokurorës së caktuar me autorizim për tu njohur me aktet dhe për të përgatitur konkluzionet me shkrim*). Nga përmbajtja e procesverbalit rezultojnë se veprimet procedurale të drejtimit të seancës janë zhvilluar me korrektësi, gjykata i ka dhënë fjalën palëve lidhur me çdo hap të ecurisë procedurale të seancës, vendimet e ndërmjetme të drejtimit të seancës si dhe vendimet për disponimin lidhur me kërkesat e palëve evidentohen qartë, pasqyrojnë arsyet dhe bazën ligjore përkatëse.

**Vendimi përfundimtar me nr. 83, datë 8.7.2014** përmban pjesën hyrëse ku evidentohet gjykata, koha dhe vendi i zhvillimit të gjyimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, gjeneralitetet e të pandehurit, mbrojtësi, akuza dhe kërkimet përfundimtare të palëve.

Në pjesën përshkruese arsyetuese rezultojnë të jetë ndjekur një strukturë e organizimit të vendimit në nënndarje ku secila përmban titullin përkatës dhe përmbajtjen sipas titullit.

Pas pjesës së parë në të cilën parashtrohen të dhënat e çështjes dhe akuza ndaj të pandehurit, vjen nënndarja e titulluar “Hetimi paraprak”, e cila përmban përshkrimin e ngjarjes si dhe veprimet procedurale të kryera dhe provat e marra në fazën e hetimit, nga momenti i ngjarjes (faktit penal) deri në momentin e dërgimit të çështjes për gjykim nga prokuroria.

Në nënndarjen e titulluar “Shqyrtimi gjyqësor” referohet paraqitja prej të pandehurit e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar si dhe vendimmarrja e gjykatës lidhur me pranimin e kësaj kërkesë, duke parashtruar vlerësimin e gjykatës për bazueshmërinë e kësaj kërkesë, referimin në bazën ligjore përkatëse, nenin 405 të K.Pr.P, dhe vendimin unifikues nr. 2/2003.

.....  
Në nënndarjen “Rrethanat e faktit”, parashtrohen rrethanat e faktit penal dhe autorësia e të pandehurit, në mënyrë të përmbledhur, siç kanë rezultuar të provuara në gjykim.

Në nënndarjen “Ligji i zbatueshëm” citohen nenet 22,23 dhe 283/a të Kodit Penal.

Në nënndarjen “Argumentimi ligjor”, gjykata evidenton sërish rrethanat e faktit siç kanë rezultuar të provuara nën gjykim, si dhe veprimet e të pandehurit të cilat përbejnë elementet e anës objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën ai procedohet. Më pas gjykata, si pjesë e argumentimit ligjor, vijon arsyetimin me evidentimin e tri fakteve thelbësore që lidhen me ekzistencën e veprës dhe autorësinë e saj (*fakti që sasia e lëndës i përkiste të pandehurit, faktin që lënda e sekuestruar të pandehurit është lëndë narkotike dhe faktin se i pandehuri ka dashur ta trafikojë lëndën jashtë territorit*) duke veçuar provat përkatëse për secilin prej këtyre tri fakteve thelbësore. Në renditjen e provave, evidentohet se ato janë referuar me vete për secilin fakt provueshmërisë së të cilit i shërbejnë.

Pas evidentimit të provave për secilin fakt, si më sipër, arsyetimi ndalet në analizën e qëllimit të të pandehurit për trafikimin e lëndës narkotike dhe mbetjen e veprës në fazën e tentativës si dhe rrethanave që kanë çuar në mbetjen e veprës penale në fazën e tentativës. Më pas arsyetimi vijon me evidentimin e provave materiale të sekuestruara dhe disponimin për to në raport me parashikimet e nenit 190 të K.Pr.P.

Në nënndarjen “Individualizimi i dënimit”, arsyetimi ndalet në evidentimin vetëm të rrethanave konkrete që janë marrë parasysh në përcaktimin e masës së dënimit të tilla si rrezikshmëria e veprës, forma e kryerjes së saj, rrezikshmëria e autorit, mungesa e elementëve të bashkëpunimit, sasia e lëndës së sekuestruar, mbetja e veprës në fazën e tentativës, dashja e drejtpërdrejtë, qëllimi për përfitim i veprës penale, mungesa e rrethanave rëndësuese, pendimi i të pandehurit si rrethanë lehtësuese në referim të nenit 48/ç të Kodit Penal.

Në pjesën e dispozitivit të vendimit evidentohet përcaktimi i të gjithë elementëve të domosdoshëm në lidhje me deklarin fajtor të të pandehurit për veprën konkrete për të cilën akuzohet dhe përcaktimi i masës së dënimit në raport me parashikimet e nenit 283/a/1 dhe 22 të K. Penal. ulja e masës së dënimit me 1/3 për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, koha e fillimit të vuajtjes së dënimit dhe lloji i institucionit në të cilin do të vuhet dënimi, disponimi për provat materiale të sekuestruara në raport me parashikimet e nenit 190 të K.Pr.P, disponimi për shpenzimet procedurale, urdhërimin e Prokurorisë kompetente për ekzekutimin e vendimit si dhe e drejta e ankimit ndaj vendimit të gjykatës duke përcaktuar afatin e ankimit dhe gjykatën kompetente pranë të cilës mund të ushtrohet kjo e drejtë.

#### KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 3 seanca gjyqësore të cilat janë dokumentuar në procesverbal;
- Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 3 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).

- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra kohore, duke respektuar në çdo rast afatin procedural të parashikuar në nenin 342/2 të K.Pr.P.
- Gjykimi ka ndjekur të gjitha hapat procedurale të shqyrtimit gjyqësor, me procedurën e posaçme të gjykimit të shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e procesit gjyqësor dhe shtyrjen e seancave gjyqësore përmbajnë gjithnjë bazën ligjore procedurale dhe arsyen përkatëse;
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit, sipas një strukture standarde që ndjek gjyqtari. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar në nënndarje, përmban analizën e detajuar të faktit, provave dhe arsyetimin e gjykatës në lidhje me ekzistencën e veprës penale, autorësinë e të pandehurit, provueshmërinë e fakteve thelbësore si dhe individualizimin e dënimit. Analiza ligjore shoqërohet me referencën në dispozitat ligjore procedurale ose materiale, sipas rastit.
- Dosja gjyqësore është e plotë, përmban aktin e shortit, urdhrin për formimin e trupit gjykues, vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet e palëve për çdo seancë, renditur sipas datave, aktet e hetimeve paraprake të cilat janë bërë pjesë e fashikullit të gjykimit për herë të parë për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, diskutimet përfundimtarë të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.

**Dosja 7 (2) -Çështja penale me nr. 56 regjistri, datë regjistrimi 30.1.2014, ndaj të pandehurit Besmir Pasia (Pasha), akuzuar për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2-22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 43, datë 3.4.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.** Çështja është regjistruar në datë 30.1.2014 dhe me shortin e datës 4.2.2014 i është caktuar gjyqtarit {...} në cilësinë e kryesuesit. Më urdhrin e datës 4.2.2014 është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

**Me vendimin e datës 6.2.2014,** dy ditë pas caktimi me short, duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 333 pika 1 të K.Pr.P, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 24.2.2014 dhe urdhëruar njoftimin e palëve (*Prokurori, i pandehuri, mbrojtësit e të pandehurit*).

Janë zhvilluar gjithsej **7 seanca gjyqësore**, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio të seancave si dhe pasqyrohen në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seanca e parë e datës 24.2.2014 , nuk është zhvilluar për shkak të mos formimit të trupit gjykues për shkak se njëri nga anëtarët e trupit gjykues ka qenë pjesëmarrës në mbledhjen e KLD në cilësinë e anëtarit. Pas relatimit të këtij fakti dhe administrimit në dosje të aktit të njoftimit të anëtarit përkatës për aktivitetin në të cilin ai është angazhuar, është relatuar prezenca e palëve dhe është disponuar për caktimin e seancës vijuese, duke urdhëruar edhe njoftimet përkatëse si dhe marrjen e masave për shoqërimin e të pandehurit për seancën vijuese.

Seanca e dytë e datës 3.3.2014 ora 11.00 është zhvilluar e plotë, duke ndjekur të gjithë hapat procedurale për verifikimin e paraqitjes së palëve, legjitimimin e mbrojtësit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, pranimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar duke referuar arsyen e pranimit të saj dhe bazën ligjore përkatëse në vendimin e ndërmjetëm, deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 405 të K.Pr.P, dëgjimin e parashtrimeve të palëve, administrimin e provave në referim të nenit 371 të K.Pr.P dhe kalimin në fazën e konkluzioneve përfundimtare në referim të nenit 378 të K.Pr.P. Seanca është shtyre më kërkesë të prokurorit për paraqitjen e konkluzioneve me shkrim.

Seanca e tretë e datës 12.3.2014, është zhvilluar në prezencë të prokurorit, të pandehurit dhe një mbrojtësi tjetër të caktuar për të pandehurin, për shkak të mosparaqitjes së avokatit të zgjedhur më parë prej tij. Pas deklarimit të të pandehurit lidhur me mbrojtësin, i është dhënë fjala palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar. Pasi janë paraqitur konkluzionet përfundimtare të palëve, gjykata ka shtyrë seancën gjyqësore me kërkesë të mbrojtësit të ri të të pandehurit, për ti dhënë kohë për përgatitjen e diskutimit përfundimtar.

Seanca e katërt e datës 20.3.2014, është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësve të zgjedhur prej të pandehurit. Është verifikuar paraqitjen e palëve dhe janë relatuar shkaqet e mosparaqitjes së mbrojtësve. Seanca gjyqësore është shtyre për ti krijuar mundësi të pandehurit të asistohet nga mbrojtësit duke pezulluar dhe afatet e paraburgimit në referim të nenit 265 të K.Pr.P. Gjithashtu gjykata relatton shkaqet e mos zëvendësimit të mbrojtësve të zgjedhur me mbrojtës kryesisht, duke referuar si shkak sjelljen e tyre korrekte si dhe fazën procedurale në të cilën ndodhet gjykimi (*diskutimi përfundimtar*) dhe arsyen për të cilën caktimi i një mbrojtësi kryesisht do të dëmtonte ecurinë e gjykimit.

Seanca e datës 25.3.2014, është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësve të të pandehurit. Është relatuar paraqitja e palëve, njoftimet përkatëse për mbrojtësit, shkaqet e mosparaqitjes së tyre. Pasi është dëgjuar prokurori dhe i pandehuri lidhur me ecurinë e gjykimit, seanca është shtyre për ti siguruar të pandehurit të drejtën e mbrojtjes, duke pezulluar afatet e paraburgimit sipas nenit 265 të K.Pr.P si dhe duke relatuar shkaqet e mos zëvendësimit të mbrojtësve të zgjedhur.

Seanca e datës 1.4.2014, është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së prokurorit. Pasi rehatohet prezencja e palëve dhe shkak i mosparaqitjes së prokurorit, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën gjyqësore për të siguruar prezencën e tij duke urdhëruar edhe njoftimin e Drejtuesit të Prokurorisë.

Seanca e datës 3.4.2014 është zhvilluar në prezencë të të gjitha palëve, duke vijuar gjykimin në fazën e paraqitjes së diskutimit përfundimtar të mbrojtjes. Pasi është dëgjuar diskutimi përfundimtar i mbrojtësit të të pandehurit, i është dhënë fjala të pandehurit dhe më pas prokurorit për të bërë replikë. Pas këtij moment është deklaruar i mbyllur shqyrtimi gjyqësor referuar nenit 378 të K.Pr.P. Në këtë seancë gjykata ka shpallur vendim përfundimtar për deklarimin fajtor të të pandehurit.



⋮

**Vendimi përfundimtar me nr. 43, datë 3.4.2014**, është i organizuar në tre pjesët kryesore: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P. Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues, identitetin e palëve dhe mbrojtësit, akuzën si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në proces.

Pjesa përshkuese- arsyetuese e vendimit është e organizuar në disa pjesë duke filluar me prezantimin e çështjes të sjellë për gjykim nga prokuroria dhe akuzën ndaj të pandehurit. Më pas vijohet me nënndarjen e titulluar “Hetimet paraprake”, në të cilën parashtrrohet i detajuar faktit penal i rezultuar gjatë hetimit si dhe veprimet procedurale dhe provat e marra nga prokuroria gjatë hetimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për gjykimin e çështjes. Provat e marra gjatë hetimit paraprake dhe përmbajtja e tyre, referohet në mënyrë sintetike në këtë pjesë të arsyetimit të vendimit.

Në nënndarjen e titulluar “Shqyrtimi gjyqësor” parashtrrohet kërkesa e te pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar si dhe faktet që kanë rezultuar nga administrimi i akteve në kuadër të gjykimin të shkurtuar.

Në nënndarjen “Rrethanat e faktit” parashtrrohet fakti penal si dhe autorësia e të pandehurit, mbështetur në analizën e integruar të provave të administruara gjatë gjykimin. Analiza e faktit përmban interpretim të integruar të provave mbi të cilat ai mbështetet dhe jo citim ose referim të thjeshtë të përmbajtjes së tyre. Evidentohen në mënyrë të posaçme të dhënat që rezultojnë nga provat në lidhje me bashkëpunimin në kryerjen e veprës penale.

Në nënndarjen “ligji i zbatueshëm”, citohet neni 22, 25 dhe 283/a i Kodit Penal.

Në nënndarjen “argumentimi ligjor”, në të cilën parashtrrohet fakti penal i analizuar në mënyrë të integruar më provat mbi të cilat ai ka rezultuar i provuar në gjykim, autorësia dhe roli i të pandehurit në këtë fakt penal, qëllimi i kryerjes së veprës si dhe elementët e bashkëpunimit të të pandehurit në kryerjen e kësaj vepre.

Më pas evidentohen katër fakte të vlerësuara thelbësore lidhur me ekzistencën e veprës penale dhe autorësinë e të pandehurit (*fakti që lënda e sekuestruar i përket të pandehurit, faktin që lënda e sekuestruar është lëndë narkotike, fakti që i pandehuri ka dashur ta trafikojë dhe që vepra penale është kryer në bashkëpunim*). Për secilin nga këto fakte renditen provat specifike që lidhen me faktin konkret, duke parashtruar konkluzionet që rezultojnë prej tyre ose përmbajtjen e tyre sipas rastit, duke veçuar pjesën që ka lidhje me provueshmërinë e faktit përkatës.

Pas paraqitjes së provave, arsyetimi vijon më paraqitjen në mënyrë sintetike të elementëve që kanë rezultuar të provuar nga tërësia e tyre, duke argumentuar konkluzionin e saj për provueshmërinë e elementëve të anës objektive të veprës penale, bashkëpunimin, formën e kryerjes së veprës, qëllimin. Në analizën e rrethanës së bashkëpunimit referohet konkluzioni unifikues i vendimit nr. 4 datë 15.4.2011 lidhur me bashkëpunëtorin e paidentifikuar, duke u cituar ekstrakti i konkluzionit unifikues. Më pas në një nënndarje tjetër analizohet mbetja e veprës penale në fazën e tentativës.

Arshetimi vijon me nëndarjen e titulluar "Individualizmi i dënimit" në të cilën parashtrohen kriteret e parashikuara në nenin 47 të K.P si dhe rrethanat konkrete në raport me të pandehurit të tilla si rrezikshmëria e veprës, forma e kryerjes së veprës, sasia e lëndës së sekuestruar, mjetet dhe rrethanat me të cilat i pandehuri do të kryente vepre penale, rolin e tij në kryerjen e veprës, mbetjen e veprës në fazën e tentativës, dashjen e drejtpërdrejtë si formë e fajësisë si dhe mungesën e rrethanave rënduese dhe lehtësuese.

Pjesa e diapozitivit të vendimit është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes, disponimet mbi deklarinin fajtor të të pandehurit duke përmendur dispozitën, nenin përkatës, dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, përcaktimin e momentit të fillimit të kohës së vuajtjes së dënimit dhe llojin e burgut në të cilin do të vuhet dënimi, disponimin për provat material enë referim të nenit 190 të K.Pr.P, disponimin për shpenzimet procedurale, ngarkimin e prokurorisë për ekzekutimit e vendimit, si dhe përcaktimin e qartë për të drejtën e ankimit, gjykatën pranë së cilës mund të ushtrohet ankim si dhe afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

#### KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 7 seanca gjyqësorë nga të cilat 4 kanë qenë jo produktive. Një seancë nuk është zhvilluar për shkak të mos formimit të trupit gjykues ndërsa tre të tjera për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësve ose prokurorit. Shkaqet e shtyrjes së seancave janë relatuar nga gjyqtari si dhe rezulton të jenë marrë masa efektive për të garantuar zhvillimin e gjykimit në seancën vijues (*masa të tilla si njoftimi drejtuesit të prokurorisë, njoftimi i të dy mbrojtësve të të pandehurit, pezullimi i afateve të paraburgimit*).
- Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 3 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe çdo rast brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar në nenin 342 të K.Pr.P.
- Shtyrja e seancave ka ndodhur për shkaqe procedurale, me qëllim për të siguruar prezencën e palëve (prokurorisë në një rast ) dhe për të garantuar të pandehurit të drejtën e mbrojtjes (në 2 raste) si dhe në një rast për shkak të mosformimit të trupit gjykues.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat procedurale të zhvillimit të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet e posaçme ligjore procedurale për gjykimin e shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar mbi bazën e një forme standarde me nëndarje të cilat përmbajnë të analizuar ecurinë procedurale të procedimit, rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm dhe argumentimin ligjor të gjykatës të organizuar në disa pjesë. I kushtohet rëndësi e veçantë analizës së elementëve të tentativës dhe bashkëpunimit, duke referuar edhe nën konkluzionet unifikuese lidhur me bashkëpunëtorin e pidentifikuar. Gjithashtu në

.....  
mënyrë të veçantë evidentohen faktet thelbësore në lidhje me ekzistencën e elementëve të anës objektive të veprës penale dhe autorësinë e të pandehurit duke përcaktuar provat konkrete mbi bazën e të cilave rezultojnë të provuara këto fakte.

- Dispozitivi i vendimit është i plotë, i qartë dhe në përputhje të plotë me pjesën arsyetuese të vendimit.
- Dosja gjyqësore është e plotë, përmban aktin e shortit, urdhrin për formimin e trupit gjykues, vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet e palëve për çdo seancë, renditur sipas datave, aktet e hetimeve paraprake të cilat janë bërë pjesë e fashikullit të gjykimit për herë të parë për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, diskutimet përfundimtarë të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.

**Dosja 8 (3)** -Çështja penale me nr. 94 regjistri, datë regjistrimi 7.4.2015, ndaj të pandehurve Agim Dajaku, Idajet Duraku, Fatos Taçi, Haki Dajaku, Shaban Hoti, akuzuar për veprat penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga nenet 283/a/2-22 dhe 300 të Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 96, datë 10.9.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Çështja është regjistruar në datë 7.4.2015 dhe me shortin e datës 9.4.2015 i është caktuar gjyqtarit {...} në cilësinë e kryesuesit. Më urdhrin e datës 9.4.2015 është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

**Me vendimin e datës 10.4.2015**, një ditë pas caktimi me short, duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 333 pika 1 të K.Pr.P, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 29.4.2015, dhe urdhëruar njoftimin e palëve dhe marrjen e masave për shoqërimin e të pandehurve që ndodhen nën masa sigurimi shtrënguese.

Janë zhvilluar gjithsej **12 seanca gjyqësore**, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio të seancave si dhe pasqyrohen në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Nga 12 seanca, 9 prej tyre janë shtyrë për të bërë të mundur përsëritjen e njoftimeve të palëve, mosparaqitje të mbrojtëseve, për të siguruar prezencën e të pandehurve me qëllim dhënien e pëlqimit për procedim me gjykim të shkurtuar ose mos formim të trupit gjykues në dy seanca.

Seanca e datës 29.4.2015 nuk është zhvilluar për shkak të mos formim të trupit gjykues duke qenë se një nga anëtarët ka qenë i angazhuar në mbledhje si anëtar i KLD. Është relatuar prezenca e palëve, të pandehurve dhe mbrojtësve si dhe ehtë urdhëruar marrja e masave të nevojshme për njoftimin e subjekteve jo prezent.

Në seancat e datave 8.5.2015, 20.5.2015, 27.5.2015, pasi është verifikuar paraqitja e palëve, të pandehurve, mbrojtësve të tyre, aktet e njoftimit për secilin prej tyre, është proceduar me deklarimin e mungesës për të pandehurit, dhe më pas janë dëgjuar kërkesat e mbrojtësve dhe të pandehurve respektive për procedim me gjykim të shkurtuar. Këto seanca janë shtyrë për shkaqe procedurale të përligjura, të relatuara në çdo vendim të ndërmjetëm për shtyrje seancë, të tilla si për të siguruar të drejtën e mbrojtjes për të pandehurit, për të siguruar prezencën e të pandehurve

me qëllim dhënie e pëlqimit për procedim me gjykim të shkurtuar, përsëritjen e njoftimit për të pandehurit kur njoftimi nuk ka rezultuar i konfirmuar etj. Në çdo rast gjykata përveç relatimit të shkakut të shtyrjes së seancës ka marrë të gjitha masat procedurale për të siguruar zhvillimin e gjykimit në seancën vijuese duke proceduar, sipas rastit me njoftimin e të pandehurit nëpërmjet policisë gjyqësore sipas nenit 132/2 të K.Pr.P, urdhërimit e shoqërimit të të pandehurve jo prezent për seancën vijuese, udhëzimin e mbrojtësve për të komunikuar me të mbrojtur prej tyre me qëllim konfirmimin e vullnetit për procedim me gjykim të shkurtuar si dhe pezullimin e afateve të paraburgimit në referim të nenit 265 të K.Pr.P, sipas rastit.

Seanca e datës 5.6.2015, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, legjitimitit të mbrojtësve, deklarimin e mungesës për të pandehurit që kanë dhënë pëlqimin për vijimin e gjykimit pa prezencën e tyre, dhe marrjes së konfirmimit të të pandehurve prezent lidhur me kërkesat e paraqitur nga mbrojtësit e tyre për procedim me gjykim të shkurtuar, pasi është marrë mendimi i prokurorit, gjykimi ka vijuar me vendimmarrjen e gjykatës për pranimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar duke referuar arsyet, bazën ligjore procedurale dhe vendimin unifikues nr. 2/2003. Pas këtij momenti gjykimi ka zhvilluar duke ndjekur të gjithë hapat proceduralë të procedimit me gjykim të shkurtuar sipas parashikimeve të nenit 405 të K.Pr.P, duke u ndërprerë për ti dhënë kohë prokurorit për diskutimin përfundimtar me shkrim.

Seanca e datës 19.6.2015, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të akteve të njoftimit të tyre, është shtyrë për shkak të mos formimit të trupit gjykues për shkak të mungesës së njërit prej anëtarëve.

Seanca e datës 26.6.2015, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe akteve të njoftimit të të pandehurve, ka vijuar me deklarimin e mungesës së vullnetshme të të pandehurve që nuk janë paraqitur duke deklaruar se do të përfaqësohen nga mbrojtësit e zgjedhur dhe më pas, ka vijuar me parashtrimin e diskutimit përfundimtar të prokurorit. Pas këtij momenti seanca është ndërprerë duke pranuar kërkesën e mbrojtësve për ti lënë kohë për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

Seanca e datës 8.7.2015, pas verifikimit të paraqitjes së palëve dhe relatimit të akteve të njoftimit të tyre, është deklaruar mungesa për të pandehurit që kanë dhënë pëlqimin që gjykimi të vazhdojë pa prezencën e tyre dhe seanca është shtyrë për ti siguruar njërit prej të pandehurve prezencën e mbrojtësit të zgjedhur. Gjykata ka relatuar mos zëvendësimin e avokatit të zgjedhur, pavarësisht mosparaqitjes, për shkak të fazës së procesit (konkluzione përfundimtare) për të mos shkaktuar zvarritje te gjykimit që mund të vijnë si pasojë e caktimit të një mbrojtësi të ri. Gjithashtu është disponuar për pezullimin e afateve të paraburgimit në referim të nenit 265 të K.Pr.P.

Seanca e datës 14.7.2015, është shtyrë për shkak të mosparaqitjes pa shkaqe të përligjura të mbrojtësit të zgjedhur të njërit prej të pandehurve, duke kryer zëvendësimin e tij sipas parashikimeve të nenit 49/5 të K.Pr.P si dhe duke disponuar për njoftimin e Dhomës së Avokatisë për sjelljen e mbrojtësit.

Seancat e datave 22.7.2015 dhe 29.7.2015, pas kryerjes së veprimeve për verifikimin e paraqitjes së palëve, është shtyrë për kryer njoftimin e rregullt të një prej të pandehurve duke marrë masa për njoftimin e tij nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore.

Në çdo rast në të cilin seanca është shtyrë për shkak të kërkesave të të pandehurve ose mbrojtësve, gjykata ka urdhëruar pezullimin e afateve të paraburgimit në referim të nenit 265 të K.Pr.P.

Seanca e datës 10.9.2015 është zhvilluar në prezencë të palëve dhe përfaqësuesve të të pandehurve, dhe pas verifikimit të paraqitjes së tyre, relativitetit të akteve të njoftimit dhe disponimit me vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë për të pandehurit që nuk janë paraqitur, seanca ka vijuar me konkluzionet përfundimtarë të mbrojtësve të të pandehurve dhe më pas me deklarinimin të mbyllur të shqyrtimit gjyqësor dhe shpalljen e vendimit përfundimtar, vendim për deklarimin fajtor të të pandehurve dh dënimin e tyre.

**Vendimi përfundimtar me nr. 96, datë 10.9.2015**, është i organizuar në tre pjesët kryesore: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P.

Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues, identitetin e palëve dhe mbrojtësit, akuzën si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në proces.

Pjesa përshkuese- arsyetuese e vendimit është e organizuar në disa pjesë duke filluar me prezantimin e çështjes të sjellë për gjykim nga prokuroria dhe akuzën ndaj të pandehurit.

Më pas vijohet me nënndarjen e titulluar “Hetimet paraprake”, në të cilën parashtrrohet i detajuar faktit penal i rezultuar gjatë hetimit si dhe veprimet procedurale dhe provat e marra nga prokuroria gjatë hetimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për gjykimin e çështjes.

Në nënndarjen e titulluar “Shqyrtimi gjyqësor” parashtrrohet kërkesa e te pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar si dhe faktet që kanë rezultuar nga administrimi i akteve në kuadër të gjykimit të shkurtuar.

Nënndarjen “Rrethanat e faktit” parashtrrohet fakti penal si dhe autorësia e të pandehurve si dhe veprimet e secilit prej tyre në raport me faktin penal të ndodhur. Rrethanat e faktit përshkruhen në mënyrë kronologjike por pa u integruar në to provat mbi të cilat mbështeten faktet respektive (*analiza e provave vjen në një pjesë të dytë të vendimit*). Në nënndarjen “ligji i zbatueshëm”, citohet neni 22, 23 dhe 283/a i Kodit Penal.

Në nënndarjen “vlerësimi i gjykatës”, arsyetimi fillon me konkluzionin e gjykatës për kryerjen e veprës penale të trafikimit nga katër prej të pandehurve ne bashkëpunim me njëri tjetrin, duke vijuar me individualizimin e veprimeve për secilin të pandehur si dhe rolin e tyre në realizimin e veprës penale duke identifikuar rolin e secilit të pandehur si organizator, ndihmës, ekzekutor. Për të pandehurin Shaban Hoti i cili akuzohet për veprën penale “Moskallëzim krimi” analizohen veprime te tij në raport me mungesën e rolit në kryerjen e veprës penale te trafikimit si dhe prezencën e tij gjatë kryerjes së veprimeve për realizimin e anës objektive te veprës penale nga të

.....  
pandehurit e tjetër si dhe pasivitetin e tij në kallëzimin e krimit. Më pas evidentohen katër fakte të vlerësuara të rëndësore lidhur me ekzistencën e veprës penale dhe autorësinë e të pandehurve si dhe evidentimin e bashkëpunimit në kryerjen e veprës dhe mbetjen e saj në fazën e tentativës Për secilin nga këto fakte gjykata rendit provat specifike që lidhen me faktin konkret, shoqëruar me analizë të provave dhe konkluzionet që rezultojnë prej tyre ose përmbajtjen e tyre sipas rastit, duke veçuar pjesën që ka lidhje me provueshmërinë e faktit përkatës.

Pas paraqitjes dhe analizës së provave në raport me faktet përkatëse të vlerësuara më rëndësi të posaçme nga gjykata në analizën e vendimit, analizohen elementet e anës objektive të veprës penale të “Moskallëzim krimi”, dhe mosveprimet e të pandehurit Sh.H në lidhje me kryerjen e kësaj veprë. Arsyetimi vijon me një nënndarje të titulluar “përfundimet”, në të cilën gjykata rendit konkluzionet që rezultojnë nga analiza e integruar e provave, dhe i kushton rëndësi të veçantë veprimeve të secilit të pandehur që determinojnë rolin e tij në kryerjen e veprës.

Arsyetimi vijon me nënndarjen e titulluar “Individualizimi i dënimit” në të cilën parashtrohen kriteret e parashikuara në neni 47 të K.P si dhe rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, në mënyrë të përgjithshme dhe për të gjithë të pandehurit së bashku, duke mos u ndalur në evidentimin apo analizën e rrethanave që ndikojnë në individualizimin e dënimit për secilin të pandehur. Referimi në mënyrë individuale në këtë pjesë të arsyetimit rezulton të jetë bërë vetëm për të pandehurin Sh.H por nuk është përmendur asnjë rrethanë që ka lidhje me individualizimin e dënimit për këtë të pandehur.

Pjesa e dispozitivit të vendimit është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes, disponohet mbi deklarinimin fajtor të secilit të pandehur duke përmendur dispozitën, nenin përkatës, dhe masën e dënimit ( *masa e njëjtë e dënimit për secilin të pandehur që akuzohet për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, pavarësisht rolit të tij* ), uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, përcaktimin e momentit të fillimit të kohës së vuajtjes së dënimit dhe llojin e burgut në të cilin do të vuhet dënimi, dispononin për provat materiale në referim të nenit 190 të K.Pr.P, deponimin për shpenzimet procedurale, ngarkimin e prokurorisë për ekzekutimin e vendimit, si dhe përcaktimin e qartë për të drejtën e ankimit, gjykatën pranë së cilës mund të ushtrohet ankimi si dhe afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

#### KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 12 seanca gjyqësore nga të cilat 9 kanë qenë jo produktive. Seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale dhe rezulton që në çdo rast gjyqtari ka marrë gjithë masat e nevojshme për të siguruar vijimin e gjykimit në seancën vijuese (*masa të tilla si njoftimi i të pandehurve ndaj policisë gjyqësore, caktimi avokatit kryesisht, marrja e masave për shoqërimin e të pandehurve në seancë, njoftimi i Dhomës së Avokatisë për shkak shtyrjes së gjykimit si pasojë e mosparaqitjes së avokatit, pezullimi i afateve të paraburgimit*).
- Gjykimi ka zgjatur 6 muaj e 3 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari, pavarësisht numrit të të pandehurve, duke përfunduar në një afat relativisht të shkurtër. Seancat janë planifikuar

⋮  
dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe çdo rast brenda afatit procedural 15 ditore të parashikuar në nenin 342 të K.Pr.P.

- Shtyrja e seancave ka ndodhur për shkak procedural, të tilla si mos formimi i trupit gjykues, për të siguruar prezencën e palëve, për të garantuar të pandehurit të drejtën e mbrojtjes, për të siguruar prezencën e të pandehurve me qëllim konfirmimin e vullnetit për procedim me gjykim të shkurtuar.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat procedural të zhvillimit të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet e posaçme ligjore procedural për gjykimin e shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohet qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar mbi bazën e një forme standarde me nënndarje të cilat përmbajnë të analizuar ecurinë procedural të procedimit, rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm dhe argumentimin ligjor të gjykatës të organizuar në disa pjesë. I kushtohet rëndësi e veçantë analizës së faktit dhe përcaktimit të rolit të secilit prej të pandehurve në kryerjen e veprës penale.
- Dispozitivi i vendimit është i plotë, i qartë dhe në përputhje të plotë me pjesën arsyetuese të vendimit.
- Dosja gjyqësore është e plotë, përmban aktin e shortit, urdhrin për formimin e trupit gjykues, vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet e palëve për çdo seancë, renditur sipas datave, aktet të cilat janë bërë pjesë e fashikullit të gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, diskutimet përfundimtare të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.

**Dosja 9 (4) -Çështja penale me nr. 148 regjistri, datë regjistrimi 20.7.2015, ndaj të pandehurit Blerim Ballabani, akuzuar për veprën penale “Trafikimi i armëve dhe municionit”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 278/a/1-22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 111, datë 12.10.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.** Çështja është regjistruar në Gjykatë më datë 20.7.2015, dhe me shortin e datës 23.7.2015 i është caktuar gjyqtarit {...}. Më urdhrin e datës 23.7.2015 është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

**Me vendimin e datës 24.7.2015,** një ditë pas caktimi me short, duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 333 pika 1 të K.Pr.P, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 7.9.2015 ora 14.00, dhe urdhëruar njoftimin e palëve dhe marrjen e masave për shoqërimin e të pandehurit. Seanca është caktuar pas 1 muaji e 14 ditë për shkak të lejes vjetore të gjykatës në muajin Gusht të çdo viti.

Janë zhvilluar gjithsej 4 seanca gjyqësore, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio të seancave si dhe pasqyrohen në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Nga 4 seanca, 2 prej tyre janë shtyrë për të bërë të mundur prezencën e përfaqësuesit të prokurorisë dhe

.....  
përsëritjen e njoftimit për avokatin e zgjedhur prej të pandehurit dhe për shkak të mos formimit të trupit gjykues për shkak të angazhimit të njërit prej anëtarëve në një aktivitet jashtë shtetit.

Seanca e datës 7.9.2015 nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të prokurorisë si dhe për të përsëritur njoftimin për avokatin e të pandehurit.

Seanca e datës 14.9.2015 nuk është zhvilluar për shkak të mos formimit të trupit gjykues për shkak të mungesës së një prej anëtarëve, sipas shkakut të relatuar në seancë.

Në të dy këto seanca, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, akteve të njoftimit dhe shkaqeve të shtyrjes së seancave, është disponuar për marrjen e masave për njoftimin e palëve dhe shoqërimin e të pandehurit, për të siguruar zhvillimin e gjykimit në seancat vijuese.

Seanca e datës 29.9.2015 është zhvilluar në prezencë të palëve dhe mbrojtësit të të pandehurit, duke ndjekur të gjithë hapat procedurale të gjykimit penal sipas parashikimeve të nenit 355 e vijues dhe 405 të K.Pr.P, të tilla si verifikimi i paraqitjes së palëve, legjitimimi i mbrojtësit, shpallja e gjykatës, dëgjimi i kërkesave paraprake të palëve, disponimi me vendim për kërkesën e të pandehurit dhe mbrojtësit për procedim me gjykim të shkurtuar duke referuar bazën ligjore procedurale të pranimit të kërkesës dhe vendimin unifikues nr. 2/2003, deklarin e hapur të shqyrtimit gjyqësor, dëgjimin e palëve, lejimin e provave, administrimin e tyre, deklarin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor. Seanca është shtyrë për ti dhënë kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

Seanca e datës 12.10.2015 është zhvilluar në prezencë të palëve dhe pas dëgjimit dhe administrimit të diskutimeve përfundimtare me shkrim të palëve, gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për deklarin fajtor dhe dënimin e të pandehurit.

**Vendimi përfundimtar me nr. 111, datë 12.10.2015**, është i organizuar në tre pjesët kryesore: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P.

Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues, identitetin e palëve dhe mbrojtësit, akuzën si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në proces.

Pjesa përshkuese- arsyetuese e vendimit është e organizuar në disa pjesë duke filluar me prezantimin e çështjes të sjellë për gjykim nga prokuroria, akuzën ndaj të pandehurit dhe rrethanat e faktit objekt akuze si dhe veprimet procedurale dhe provat e marra gjatë fazës së hetimit paraprak. Më pas në nënndarjen “shqyrtimi gjyqësor” pasqyrohet kërkesa e të pandehurit dhe mbrojtësit për procedim me gjykim të shkurtuar, faza procedurale e paraqitjes së saj si dhe vendimmarrja e gjykatës për pranimin e kërkesës.

Në nënndarjen “rrethanat e faktit” parashtrohen rrethanat e faktit penal dhe roli i të pandehurit në raport me faktin objekt akuze siç kanë rezultuar të provuara në gjykim. Më pas vijohet me “provat e shqyrtuara në gjykim”, nënndarje në të cilën paraqiten duke u cituar pjesërisht deklarinet e marra gjatë hetimit paraprak, si dhe provat e tjera të administruara gjatë gjykimit.



Arshyetyimi vijon me nënndarjen “ligji i zbatueshëm” në të cilën citohen nenet 22, 278, 278/a/1 të Kodit Penal dhe neni 375 i Kodit të Procedurës Penale.

Në nënndarjen “vlerësimi i gjykatës” gjykata ka parashtruar konkluzionin për ndryshimin e akuzës ndaj të pandehurit në referim të nenit 375 të K.Pr.P, nga vepra penale e parashikuar nga neni 278/a/1 në lidhje me nenin 22 në veprën penale të parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, në mjedise të hapura për publikun. Pas parashtrimit të këtij konkluzioni arshyetyimi vijon më analizën e faktit të provuar në gjykim, duke analizuar veprimet konkrete të të pandehurit në realizimin e elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën procedohet. Gjykata ndalet në përcaktimin e episodit të mbajtjes së armës si dhe në rrethanën cilësuese të mbajtjes së saj në mjedise të hapura për publikun, duke përcaktuar këto mjedise. Më pas arshyetyimi ndalet në analizën e mungesës së elementëve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 278/a/1 në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal duke argumentuar mungesën e provueshmërisë së qëllimit të mbajtjes së armës në një nga format e trafikimit, me qëllim përfitimi, si element thelbësor i ekzistencës së veprës penale të trafikimit për të cilën është sjellë për gjykim i pandehuri. Në arritjen e këtij konkluzioni referohet në qëndrimin e mbajtur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 202, datë 11.7.2012.

Në nënndarjen “individualizimi i dënimit” parashtrohen dhe argumentohen kur është rasti, rrethanat për caktimin e dënimit sipas nenit 47 të K.Penal, të tilla si rrezikshmëria e veprës penale, rrezikshmëria e autorit, rrethana cilësuese, forma e dashjes (dashje direkte), mungesa e rrethanave rënduese, rrethanën lehtësuese të pendimit të thellë të të pandehurit.

Pjesa e dispozitivit të vendimit është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes, disponohet mbi deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprën penale për të cilën është konkluduar, pas ndryshimit të kualifikimit në pjesën arshyetyuese të vendimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, përcaktimin e momentit të fillimit të kohës së vuajtjes së dënimit dhe llojin e burgut në të cilin do të vuhet dënimi, dispononin për provat materiale në referim të nenit 190 të K.Pr.P, disponimi për shpenzimet procedurale, ngarkimin e prokurorisë për ekzekutimin e vendimit, si dhe përcaktimin e qartë për të drejtën e ankimit, gjykatën pranë së cilës mund të ushtrohet ankimi si dhe afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

#### KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 4 seanca gjyqësore nga të cilat 2 kanë qenë jo produktive. Seancat nuk janë zhvilluar ose janë shtyrë për shkaqe procedurale të përligjura (mosparaqitja e prokurorit dhe mbrojtësit, mos formimi i trupit gjykues, dhënia kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim) dhe rezultoi që në çdo rast gjykata ka marrë gjithë masat e nevojshme për të siguruar vijimin e gjykimit në seancën vijuese.
- Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 22 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari, duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe në çdo rast

...  
brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar në nenin 342 të K.Pr.P. Vetëm në një rast dhe konkretisht seanca e parë gjyqësore është planifikuar tej këtij afati për shkak të lejes vjetore të gjykatës në muajin Gusht.

- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat procedurale të zhvillimit të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet e posaçme ligjore procedurale për gjykimin e shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohet qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar mbi bazën e një forme standarde me nënndarje të cilat përmbajnë të analizuarra ecurinë procedurale të procedimit, rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm, argumentimin ligjor të gjykatës të organizuar në disa pjesë. I kushtohet rëndësi e veçantë analizës së faktit si dhe analizës së mungesës së provave për të provuar qëllimin e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, si rezultat i së cilës është konkluduar për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal.
- Gjithashtu, pas konkluzionit për ndryshimin e kualifikimit, evidentohen faktet thelbësore në lidhje me ekzistencën e elementëve të anës objektive të veprës penale, autorësinë e të pandehurit dhe veprimet konkrete të tij për realizimin e veprës, duke përcaktuar provat mbi bazën e të cilave rezultojnë të provuara këto fakte.
- Diapozitivi i vendimit është i plotë, i qartë dhe në përputhje të plotë me pjesën arsyetuese të vendimit.
- Dosja është e plotë dhe renditja e akteve e rregullt, sipas llojit të akteve dhe brenda llojit, sipas datave dhe përmban aktin e zhvillimit të shortit, urdhrin për formimin e trupit gjykues, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet e palëve, deklaratimet e marra gjatë hetimit paraprak të cilët janë bërë pjesë e dosjes për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave, diskutimet me shkrim të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.

**Dosja 10 (5) -Çështja penale me nr. 155 regjistri, datë regjistrimi 27.7.2016, ndaj të pandehurve Arben Bozhiqi, Sokol Kraja, Eribert Seferaj, akuzuar për veprën penale “Shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie”, në bashkëpunim, , parashikuar nga neni 109/b/1-25 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 112, datë 27.9.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.** Çështja është regjistruar në datë 27.7.2016 dhe me shortin e datës 28.7.2016 i është caktuar gjyqtarit {...} në cilësinë e kryesuesit. Më urdhrin e datës 28.7.2017 është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

**Me vendimin e datës 28.7.2106,** në të njëjtën ditë të caktimit me short, duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 333 pika 1 të K.Pr.P, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 16.9.2016, dhe urdhëruar njoftimin e palëve dhe marrjen e masave për shoqërimin e të pandehurve që ndodhen nën masa sigurimi shtrënguese. Gjykata ka marrë masa për të siguruar njoftimin dhe pjesëmarrjen e një psikologu në seancë për të asistuar të pandehurit e mitur në kohën e kryerjes së veprës. Seanca është caktuar në muajin Shtator për shkak të lejes vjetore të gjykatës në muajin gusht. Janë zhvilluar

gjithsej 2 seanca gjyqësore, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio të seancave si dhe pasqyrohen në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seanca e datës 16.9.2016 është zhvilluar në prezencë të palëve dhe mbrojtësve të të pandehurve, duke ndjekur të gjitha hapat proceduralë të zhvillimit të gjykimit si verifikimi i paraqitjes së palëve, legjitimi i mbrojtësve të të pandehurve, caktimi i psikologes për të asistuar dy prej të pandehurve të mitur në kohën e kryerjes së veprës, legjitimimin e mbrojtësve, deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor, shqyrtimin e kërkesave paraprake të palëve, pranimin e kërkesës së të pandehurve për procedim me gjykim të shkurtuar me vendim të ndërmjetëm në të cilin relatohen arsyet e pranimit të kërkesës si dhe baza ligjore përkatëse, deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor, dëgjimin e palëve, administrimin e provave, deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor. Seanca është shtyrë duke pranuar kërkesën e prokurorit për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

Në seancën e datës 27.9.2016, zhvilluar në prezencë të palëve, mbrojtësve dhe psikologes së caktuar për të asistuar të pandehurit e mitur, janë dëgjuar diskutimet përfundimtare të palëve, kërkimet përfundimtare të të pandehurve, është deklaruar i mbyllur shqyrtimi gjyqësor dhe është shpallur vendimi përfundimtar për deklarimin fajtor dhe dënimin e të pandehurve.

**Vendimi përfundimtar me nr. 112, datë 27.9.2016**, është i organizuar në tre pjesët kryesore: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P.

Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues, identitetin e palëve dhe mbrojtësve dhe prezencën e psikologes, akuzën për secilin të pandehur si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në proces.

Pjesa përshkuese- arsyetuese e vendimit është e organizuar në disa pjesë duke filluar me prezantimin e çështjes të sjellë për gjykim nga prokuroria dhe akuzën ndaj të pandehurve.

Më pas vijohet me nënndarjen e titulluar “Hetimet paraprake”, në të cilën parashtrohet i detajuar faktit penal i rezultuar gjatë hetimit, veprimet e secilit të pandehur, si dhe veprimet procedurale dhe provat e marra nga prokuroria gjatë hetimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për gjykimin e çështjes.

Në nënndarjen e titulluar “Shqyrtimi gjyqësor” në të cilën evidentohet kompetenca lëndore e gjykatës si dhe parashtrohet kërkesa e të pandehurve për procedim me gjykim të shkurtuar si dhe vendimmarrja e gjykatës për pranimin e kërkesës.

Nënndarjen “Rrethanat e faktit” parashtrohet fakti penal, autorësia e të pandehurve si dhe veprimet në rend kronologjik të secilit prej tyre në raport me faktin penal të ndodhur. Rrethanat e faktit përshkruhen në mënyrë të detajuar në raport me faktet që kanë rezultuar të provuara gjatë gjykimit por pa cilësuar provat mbi të cilat ato mbështeten pasi analiza dhe parashtrimi i provave është bërë në një pjesë të mëtejshme të arsyetimit. Në nënndarjen “ligji i zbatueshëm”, citohet neni 24, 25, 51, 59, 60, 109/b/a të Kodit Penal dhe nenet 404 dhe 406/1 të Kodit të Procedurës Penale.

.....

Në nënndarjen “vlerësimi i gjykatës”, arsyetimi përmban evidentimin e ekzistencës së faktit penal që përbën veprën penale objekt akuze dhe evidentimin e të gjitha provave që provojnë ekzistencën e tij. Provat janë parashtruar dhe analizuar të integruara me analizën e gjykatës mbi faktin penal dhe më pas evidentimin e autorësisë, veprimeve konkrete dhe provave respektive për secilin prej të pandehurve. Për shkak të natyrës specifike të faktit penal për të cilin procedohet, provat janë parashtruar dhe në disa raste të nevojshme edhe cituar përmbajtja e pjesëve të veçanta të tyre. Gjithashtu i kushtohet rëndësi analizës së elementëve të bashkëpunimit të të pandehurve në realizimin e anës objektive dhe subjektive të veprës penale.

Pas analizës së provave në një nënndarje të titulluar “përfundimet” gjykata parashtron dhe analizon konkluzionet e arritura për ekzistencën dhe provueshmërinë e akuzës si dhe rolin e secilit të pandehur dhe elementët e bashkëpunimit të tyre në raport me faktin penal objekt akuze.

Arsyetimi vijon me nënndarjen e titulluar “individualizimi i dënimit” duke renditur dhe analizuar rrethanat që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit për të gjithë të pandehurit të tilla si rrezikshmëria e veprës penale, rrezikshmëria e autorëve, pasojën materiale dhe vlerën e vogël të produktit të veprës penale, pasojat e veprës penale tek e dëmtuara dhe rrethanat e kryerjes së veprës. Më pas përcaktohet roli i secilit të pandehur si dhe veprimet e secilit prej tyre në raport me vlerësimin e rrezikshmërisë së secilit autor të veprës, të dhënat për personalitetin e tyre, shkallën e fajësisë, rrethanat lehtësuese të tilla si pendimin thellë të tyre, heqjen dorë vullnetarisht prej tyre nga marrja e parave prej të dëmtuarës me pasojë pakësimin e pasojave të veprës, kryerjen e veprës penale me shumë se njëherë si rrethanë rënduese. Gjithashtu gjykata ka arsyetuar lidhur me shkaqet e aplikimit të pezullimit të dënimit me burgim për të pandehurit, qenien të mitur në kohën e kryerjes së veprës për dy prej të pandehurve, mos ndërprerjen e arsimimit për njërit prej tyre.

Pjesa e dispozitivit të vendimit është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes, disponohet mbi deklarimin fajtor të secilit të pandehur duke përmendur dispozitën, nenin përkatës, dhe masën e dënimit ( masa e dënimit është e ndryshme për secilin të pandehur, referuar rolit të tyre në kryerjen e veprës dhe rrethanat specifike të individualizimit të dënimit, në përputhje me pjesën arsyetuese të vendimit) , uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim në referim të nenit 59 të Kodit Penal dhe vënien e të pandehurve në provë duke përcaktuar detyrime shtesë gjatë kohës së provës, në mënyrë të veçantë për secilin të pandehur, sipas parashikimeve të nenit 60 të Kodit Penal, dispononin për provat materiale në referim të nenit 190 të K.Pr.P, deponimin për shpenzimet procedurale, si dhe përcaktimin e qartë për të drejtën e ankimit, gjykatën pranë së cilës mund të ushtrohet ankim si dhe afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

#### KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 2 seanca gjyqësore produktive. Seanca e parë është shtyrë për të lënë kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.
- Gjykimi ka zgjatuar 2 muaj, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale.

- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari, duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe janë marrë masat për respektimin e të drejtave procedurale të palëve si dhe për të siguruar asistencë psikologjike për dy prej të pandehurve të mitur në kohën e kryerjes së veprës.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat procedurale të zhvillimit të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet e posaçme ligjore procedurale për gjykimin e shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohet qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar mbi bazën e një forme standarde me nënndarje të cilat përmbajnë të analizuar ecurinë procedurale të procedimit, rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm dhe argumentimin ligjor të gjykatës të organizuar në disa pjesë. I kushtohet rëndësi e veçantë analizës së faktit dhe përcaktimit të rolit të secilit prej të pandehurve në kryerjen e veprës penale si dhe evidentimit në mënyrë të veçantë të rrethanave lehtësuese dhe rënduese në individualizimin e dënimit për secilin si dhe arsyeve të aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim në referim të nenit 59 të Kodit Penal.
- Dispozitivi i vendimit është i plotë, i qartë dhe në përputhje të plotë me pjesën arsyetuese të vendimit.
- Dosja gjyqësore është e plotë dhe renditja e akteve e rregullt, sipas llojit të akteve dhe brenda llojit, sipas datave dhe përmban aktin e zhvillimit të shortit, urdhrin për formimin e trupit gjykues, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet e palëve, deklaratimet e marra gjatë hetimit paraprak të cilët janë bërë pjesë e dosjes për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave, diskutimet me shkrim të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.

**Dosja 11 (6) -Çështja penale me nr. 97 regjistri, datë regjistrimi 22.2.2016, ndaj të pandehurit Aleks Mema, akuzuar për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/1-22 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. 46, datë 7.4.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.** Çështja është regjistruar në datë 22.2.2017 dhe me shortin e datës 23.2.2016 i është caktuar gjyqtarit {...} në cilësinë e kryesuesit. Më urdhrin e datës 23.2.2016 është formuar trupi gjykues me pesë gjyqtarë për gjykimin e çështjes.

**Me vendimin e datës 25.2.2016,** dy ditë pas caktimi me short, duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 333 pika 1 të K.Pr.P, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari kryesues duke caktuar seancën gjyqësore më datë 18.3.2016 dhe urdhëruar njoftimin e palëve (*Prokurori, i pandehuri, mbrojtësit e të pandehurit*).

Janë zhvilluar gjithsej 3 seanca gjyqësore, të cilat janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio të seancave si dhe pasqyrohen në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seanca e parë e datës 18.3.2016 ora 9.00, është zhvilluar e plotë, duke ndjekur të gjithë hapat procedurale për verifikimin e paraqitjes së palëve, legjitimitimin e mbrojtësit, shpalljen e gjykatës,

.....  
dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, pranimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar duke referuar arsyen e pranimin të saj dhe bazën ligjore përkatëse në vendimin e ndërmjetëm, deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 405 të K.Pr.P, dëgjimin e parashtrimeve të palëve, administrimin e provave në referim të nenit 371 të K.Pr.P dhe kalimin në fazën e konkluzioneve përfundimtare në referim të nenit 378 të K.Pr.P. Seanca është shtyrë me kërkesë të prokurorit për paraqitjen e konkluzioneve me shkrim.

Seanca e datës 7.4.2016 ora 12.00 është zhvilluar në prezencë të prokurorit, të pandehurit dhe njërit nga dy mbrojtësit e zgjedhur prej të pandehurit. Pasi janë është dëgjuar diskutimi përfundimtar i mbrojtësit të të pandehurit, i është dhënë fjala të pandehurit dhe më pas prokurorit për të bërë replikë. Pas këtij moment është deklaruar i mbyllur shqyrtimi gjyqësor referuar nenit 378 të K.Pr.P. Në këtë seancë gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar për deklarimin fajtor të të pandehurit.

**Vendimi përfundimtar me nr. 46, datë 7.4.2016**, është i organizuar në tre pjesët kryesore: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P.

Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues, identitetin e palëve dhe mbrojtësit, akuzën si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në proces.

Pjesa përshkuese- arsyetuese e vendimit është e organizuar në disa pjesë duke filluar me prezantimin e çështjes të sjellë për gjykim nga prokuroria dhe akuzën ndaj të pandehurit.

Më pas vijohet me nënndarjen e titulluar “Hetimet paraprake”, në të cilën parashtrohet i detajuar faktit penal i rezultuar gjatë hetimit si dhe veprimet procedurale dhe provat e marra nga prokuroria gjatë hetimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për gjykimin e çështjes.

Në nënndarjen e titulluar “Shqyrtimi gjyqësor” parashtrohet kërkesa e të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar si dhe vendimmarrja e gjykatës për pranimin e kërkesës duke parashtruar arsyet e pranimin si dhe referuar bazën ligjore procedurale dhe vendimin unifikues nr. 2/2003 të Gjykatës së Lartë.

Në nënndarjen “Rrethanat e faktit” parashtrohet fakti penal si dhe autorësia e të pandehurit, mbështetur në analizën e integruar të provave të administruara gjatë gjyqimit. Analiza e faktit përmban interpretim të integruar të provave mbi të cilat ai mbështetet akuza si dhe provat që dëshmojnë veprimet konkrete të të pandehurit për realizimin e veprës penale.

Në nënndarjen “ligji i zbatueshëm”, citohet neni 22, 23 dhe 283/a i Kodit Penal.

Në nënndarjen “argumentimi ligjor”, në të cilën parashtrohet fakti penal i analizuar në së bashku me provat mbi të cilat ai ka rezultuar i provuar në gjykim, autorësia dhe roli i të pandehurit në këtë fakt penal, qëllimi i kryerjes së veprës si dhe mbetja e veprës penale në fazën e tentativës. Arsyetimi vijon me nënndarjen e titulluar “Individualizimi i dënimit” në të cilën parashtrohen kriteret e parashikuara në nenin 47 të K.P si dhe rrethanat konkrete në raport me të pandehurin të

.....  
tilla si rrezikshmëria e veprës, forma e kryerjes së veprës, sasia e lëndës së sekuestruar, mjetet dhe rrethanat me të cilat i pandehuri do të kryente veprë penale, rolin e tij në kryerjen e veprës, mbetjen e veprës në fazën e tentativës, dashjen e drejtpërdrejtë si formë e fajësisë, mungesën e rrethanave rënduese, rrethanat lidhur me gjendjen familjare dhe sociale të të pandehurit. Në këtë pjesë arsyetohet ulja e dënimit nën minimum sipas parashikimeve të nenit 23 të Kodit Penal për shkak të mbetjes së veprës penale në fazën e tentativës, shkallën e afërsisë së pasojës, sasinë dhe llojin e lëndës së sekuestruar, shkaqet ekonomike që e kanë shtyrë të pandehurin në ndërmarrjen e veprimeve për kryerjen e veprës penale, rrethana këto të analizuara në raport me parashikimet e nenit 23 të Kodit Penal për uljen e dënimit nën minimumin e parashikuar nga dispozita konkrete.

Pjesa e dispozitivit të vendimit është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes, disponimet mbi deklarinin faktor të të pandehurit duke përmendur dispozitën, nenin përkatës, dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykitimit të shkurtuar, përcaktimin e momentit të fillimit të kohës së vuajtjes së dënimit dhe llojin e burgut në të cilin do të vuhet dënimi, disponimin për provat material enë referim të nenit 190 të K.Pr.P, disponimin për shpenzimet procedurale, ngarkimin e prokurorisë për ekzekutimit e vendimit, si dhe përcaktimin e qartë për të drejtën e ankimit, gjykatën pranë së cilës mund të ushtrohet ankim si dhe afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

#### KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 3 seanca gjyqësorë dhe nuk rezultojnë seanca jo produktive.
- Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 15 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykitimet penale.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe në çdo rast brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar në nenin 342 të K.Pr.P.
- Shtyrja e seancave ka ndodhur për shkaqe procedurale, për ti lënë kohë prokurorit dhe më pas mbrojtësit për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat procedurale të zhvillimit të gjykitimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet e posaçme ligjore procedurale për gjykimin e shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.P. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar mbi bazën e një forme standarde me nënndarje të cilat përmbajnë të analizuara ecurinë procedurale të procedimit, rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm dhe argumentimin ligjor të gjykatës të organizuar në disa pjesë. I kushtohet rëndësi e veçantë analizës së elementëve të individualizimit të dënimit dhe kritereve dhe rrethanave të uljes së dënimit nën minimumin e parashikuar nga ligji, në raport me parashikimet e nenit 23 të Kodit Penal.
- Dispozitivi i vendimit është i plotë, i qartë dhe në përputhje të plotë me pjesën arsyetuese të vendimit.

- Dosja gjyqësore është e plotë dhe e rendit në mënyrë të rregullt dhe të lehtësisht të aksesueshme duke përmbytur aktin e shortit, urdhrin e formimit të turpit gjykues, vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, provat e administruara për herë të patë në dosje për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave sipas datave, diskutimet me shkrim të palëve dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

### **Prova të reja të paraqitura nga gjyqtari dhe të administruara në seancë dëgjimore :**

Në seancë dëgjimore u administruan prova të reja të paraqitura nga gjyqtari që tregonin angazhimin e tij në veprimtari të tjera profesionale ndërinstitucionale si dhe publikime ligjore si më poshtë :

1. Vërtetim me datë 4.3.2020 lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës sipas të cilit *“Vërtetohet se Dr. {...} është angazhuar si pedagog i jashtëm pranë Departamentit të së Drejtës Penale në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet akademike 2010-2020. Nga viti 2017 e në vazhdim është angazhuar si “Lektor” në lëndën “Procedurë Penale e Avancuar”, Cikli i II-të”.*
2. Vërtetim me nr. 325 prot, datë 3.3.2020 lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës sipas të cilit vërtetohet se gjyqtari {...} ka mbrojtur punimin me temë *“Akuzat e reja në procesin penal”*, me vlerësimin 100 pikë, *“Shumë mirë”*, për mbrojtjen e gradës shkencore *“Doktor”*, më datë 11.1.2018.
3. Referim në konferencën shkencore ndërkombëtare me temë *“Përafrimi i legjislacionit shqiptar me EU Acquis, perspektivat dhe sfidat”*, organizuar nga Ministria e Ministrisë e Integritimit Europian në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, me mbështetjen e SMEI-3. Referimi i gjyqtarit {...} në këtë aktivitet ndodhet në faqen 124-134 të materialit të konferencës dhe përbën një referim së bashku me një autor tjetër (Ph.D Lirime Çukaj me temë *“Masat e marra nga shteti shqiptar për përafrimin e legjislacionit lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë të ardhur nga krimi, jashtë procedimit penal”*). ISBN 978-89-995651-7-5.
4. Referim në konferencën shkencore ndërkombëtare me temë *“Ligji penal dhe zbatimi i tij”*, Tiranë 2014. Në këtë konferencë gjyqtari ka referuar temën *“Ndikimi i procedimit penal në përcaktimin e parimeve të procedimit penal në Republikën e Shqipërisë”*, në bashkautorësi me Znj. Erjena Bashari, ndodhur në faqen 95 -101 të materialit të konferencës botuar nga Albanian University. ISBN 978-9928-127-52-5.
5. Botim në Revistën studimore shkencore të Qendrës Kërkimore Zhvillimore Peja, Buletini Shkencor nr.1, me ISSN 1800-9794, Nëntor 2014, artikulli me temë *“Reforma ligjore shqiptare dhe integrimi europian”*, faqe 517-525, në bashkautorësi me znj. Lirime Çukaj.



6. Botim në Revistën “Mediterranean Journal of Social Sciences” vol 7, Maj 2016, me temë “Gjykimin i shkurtuar”, faqe 235-239, me ISSN 2039-2117.

7. Referim në konferencës shkencore ndërkombëtare me temë “Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, Maj 2016, faqe 73-90 të materialit të konferencës botuar nga Wisdom University, Prezenca në Shqipëri, ISBN 978-9928-4356-1-3

Rezultat e analizës së burimeve të mësipërme të vlerësimit, pasqyrohen në vlerësimin e kriterit të “aftësive personale dhe angazhimit profesional të gjyqtarit.

---

## **ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI**

---

### **1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.*

#### **1.A. NJOHURITË LIGJORE**

##### **1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjorë dhe 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. ....Evidenton natyrën e mosmarrëveshjes dhe gjykatën kompetente...”.

⋮

*Nga analiza e hurrimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

⋮

**Përcaktimin i fakteve të çështjes**, në 12 nga 14 vendimet e analizuara gjendet në dy pjesë të veçanta të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ndërsa në 2 vendimet e tjera faktet e çështjes janë parashtruar në një pjesë të arsyetimit të vendimit, duke iu referuar provave të marra në gjykim dhe analizës së integruar të tyre në mbështetje të faktit penal të provuar në gjykim (dosja 5 dhe vendimi 3).

Gjyqtari përgjithësisht evidenton në një nënndarje të veçantë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit rrethanat e faktit sikurse kanë rezultuar gjatë fazës së hetimit paraprak, veprimet procedurale dhe provat e marra gjatë fazës së hetimeve paraprake. Në një nënndarje të dytë, pjesë e vlerësimit të gjykatës për faktet, përshkruhen rrethanat e faktit të rezultuara si të provuara gjatë gjykimit, shoqëruar më pas me ndarjen dhe renditjen e provave respektive, në mënyrë të veçantë për secilin element të faktit të vlerësuar të rëndësishëm, lidhur me provueshmërinë e elementëve të figurës së veprës penale dhe lidhjen e autorit apo autorëve, me kryerjen e veprës. Paraqitja dhe analiza e provave në drejtim të evidentimit të faktit objekt gjykimi dhe rëndësia që i kushtohet evidentimit të fakteve thelbësore dhe provueshmërisë së secilit prej tyre, është karakteristikë e pjesës përshkruese arsyetuese të të gjithë vendimeve objekt vlerësimi të gjyqtarit.

Analiza e rrethanave të faktit në pjesën e dytë, që përbën edhe faktin penal që ka rezultuar i provuar gjatë gjykimit, bëhet duke i kushtuar rëndësi të posaçme analizës së provave në raport me secilin fakt, në mënyrë specifike. Kjo pjesë e paraqitjes së faktit penal, përveç evidentimit të provave për secilin fakt të veçuar nga gjyqtari si të rëndësishëm në raport me provueshmërinë, shoqërohet në pjesën e vlerësimit të gjykatës, në raport me aspekte të faktit penal të marra në analizë sa i përket provueshmërisë së elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, posaçërisht elementët e bashkëpunimit (dosja 10); format e veçanta të bashkëpunimit dhe faktet që provojnë ekzistencën e këtyre formave (vendimi 1, vendimi 2); mbetjen e veprave penale në fazën e tentativës (Dosja 1, Dosja 2, Dosja 6, Dosja 7, Dosja 8, Dosja 9, Dosja 11); lidhjen shkakësore, qëllimin kur ai përbën element të domosdoshëm për ekzistencën e veprës penale (dosja 9); autorësinë, cilësinë dhe rolin e secilit të pandehur në faktin penal të provuar (dosja 8, dosja 10); mungesën e elementeve të bashkëpunimit kur është rasti, motivet e kryerjes së veprës penale (dosja 4); elementët cilësues të veprave penale për të cilat procedohet (dosja 9), etj. Po ashtu i kushtohet rëndësi evidentimit edhe të atyre fakteve që në kontekstin psiko-social kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale, kur është rasti (dosja 4).

Në çështjet me karakter pasuror siç është rasti i konfiskimit të pasurisë, faktet evidentohen dhe analizohen në mënyrë të hollësishme si dhe i kushtohet rëndësi qartësimi të natyrës së çështjes, pavarësisë së faktit objekt hetimi pasuror nga fakti penal për të cilin procedohet me vete në një procedim të pavarur nga procedimi për hetimin pasuror (vendimi 3), si dhe paraqitjes së plotë të provave të paraqitura nga palët në procesin me natyrë specifike siç është ai i konfiskimit të pasurisë. Në këtë vendim faktet dhe rrethanat që lidhen me pretendimet e mbrojtjes së të paditurit dhe personit të tretë paraqiten në pjesën e fundit të arsyetimit, dhe përmbajnë analizë dhe përballje të fakteve të pretenduara me faktin e provuar në gjykim.

⋮

**Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes**, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtari përcakton qartë natyrën e çështjes, duke i kushtuar rëndësi specifike përcaktimit të natyrës së saj në rastet kur procedimi është me natyrë të posaçme, sikurse është rasti i procedimeve me karakter pasuror.

**Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm**, në 14 vendimet e vëzhguara, evidentohet aftësia e gjyqtarit për të përcaktuar që në fillim të arsytimit ligjin e zbatueshëm, duke e cituar në një nënndarje të veçantë të pjesës arsyetuese dispozita të veçanta të ligjit penal material dhe procedural. Konkretisht gjyqtari ka cituar dhe më pas marrë në analizë dispozita të veçanta të ligjit procedural penal në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës (dosja 3, dosja 4, dosja 10, vendimi 1, vendimi 2); gjykimin e shkurtuar (dosja 1, 2, 3, 4,6, 7, 8, 9, 10, 11); ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale (vendimi 1); kufijtë e shqyrtimit të çështjes në rastet e kthimit për rigjykim mbi ankimin e të pandehurit (vendimi 1); zhvillimin e gjykimit pa praninë e publikut (vendimi 2), etj.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në çdo rast referohen dhe citohen dispozita të Kodit Penal të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal në lidhje me bashkëpunimin (dosja 7, dosja 10), format e veçanta të bashkëpunimit (vendimi 1), tentativën dhe përgjegjësinë penale për veprat e mbetura në këtë fazë (dosja 1, dosja 2, dosja 7, dosja 8, dosja 9, dosja 11), heqjen dorë nga kryerja e veprës penale (dosja 10), dashjen si formë e fajësisë (dosja 4), mënyrën e caktimit të dënimit, rrethanat rënduese dhe lehtësuese që ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe masë së dënimit, uljen e dënimit nën minimumin e parashikuar nga ligji (dosja 4), caktimin e dënimit për disa vepra penale (vendimi 1), veprimi i ligjit penal në kohë (vendimi 1), kushtet për caktimin e dënimit me burgim për të pandehurin e mitur (dosja 10), kushtet e aplikimit të alternativave të dënimit me burgim, posaçërisht atë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal dhe detyrimet e të dënuarit të vënë në provë sipas parashikimeve të nenit 60 të këtij Kodi (dosja 10), etj.

Në çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë në bazë të ligjit antimafia, gjykata përcakton ligjin e zbatueshëm (Ligjin nr. 10 192, datë 03.12.2009), citon ose referon dispozita të veçanta të tij lidhur me fushën e zbatimit të ligjit, marrëdhënien e procedimit pasuror me procedimin penal, kushtet e pranimit të kërkesës për konfiskimin e pasurisë, etj. (vendimi 3).

**Sa i përket aspektit të evidentimit lidhur me konfliktin e normave**, në vendimin 1, rezulton të jetë evidentuar konflikti në dukje i normave të ligjit penal mbi faktin penal objekt akuze, në shërbim të konkluzionit të gjykatës se përgjegjësia penale për pjesëmarrjen në veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal”, sipas parashikimeve të nenit 333, shkronja “a”, e Kodit Penal, nuk konkurron me formën e veçantë të bashkëpunimit në kryerjen e veprës kryesore për të cilën akuzohet të pandehurit, sipas parashikimeve të nenit 28, pg 4, i Kodit Penal. Në këtë vendim gjykata i ka kushtuar rëndësi të posaçme përballjes së këtyre dy dispozitave të Kodit Penal (njëra e pjesës së përgjithshme dhe tjetra e pjesës së posaçme) për të konkluduar se ato nuk konkurrojnë por zbatohen njëkohësisht ndaj të pandehurve, në raport me faktin penal të provuar në gjykim.

⋮  
Gjithashtu, në çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë (vendimi 3), gjyqtari, në momentin e vlerësimit të pretendimeve të mbrojtjes për cenim nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ dhe neneve 11/2 dhe 41/1 të Kushtetutës në raport me procedurën e konfiskimit të pasurisë sipas ligjit antimafia, evidenton raportin e dispozitave përkatëse duke arsyetuar për natyrën e posaçme të ligjit dhe të procedimit të zhvilluar në bazë të tij, në shërbim të konkluzionit për mos cenim të të drejtave kushtetuese të pretenduara nga mbrojtja e palës së paditur nëpërmjet zbatimit të ligjit të posaçëm antimafia.

Në raste të veçanta dhe kur ka qenë e nevojshme, gjyqtari ka identifikuar dhe aplikuar mbi faktet, si ligj të zbatueshëm, edhe dispozita të Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore” në të cilën përcaktohet si kushte të ekzistencës së veprës forma dhe qëllimi i veprës penale (vendimi 2).

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, duke evidentuar, në rastet kur ka qenë e nevojshme, edhe konfliktin e normave, kryesisht në lidhje me normat e ligjit penal material.

#### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

### **1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “Një rëndësi e veçantë i kushtohet dhe respektimit ose jo të kërkesave të ligjit penal material, dispozitave ligjore të Kodit Penal. Ai ndalet në identifikimin e kërtimeve të organit të prokurorisë dhe prapësimet e mbrojtjes, i analizon ato në raport me provat e paraqitura dhe konkludon për faktin penal, si dhe masën e dënimit që duhet caktuar. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës së procesit të rregullt ligjor

...

*dhe i zbaton ato në praktikë, duke i bërë pjesë të vendimeve gjyqësore shprehimisht. Përdorimi i referencave në jurisprudencën e mëparshëm gjyqësore behët rregullisht nëpër vendime apo në dhënien e vendimeve të ndërmjetme...Gjyqtari {...} ka njohuri shumë të mira të së drejtës penale për ato vepra që përfshihen në kompetencën e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Bën lidhjen e pjesës së përgjithshme me atë të posaçme ë Kodit Penal duke identifikuar rastin kur vepra penale nuk është përfunduar, është ndërprerë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe masa e dënimit është caktuar në kufijtë minimalë që parashikon dispozita konkrete.....”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Normat ligjore të ligjit procedural dhe material, pasi citohen në një nënndarje të pjesës arsyetuese të vendimit, interpretohen dhe aplikohen mbi faktet në pjesën e “vlerësimit të gjykatës”. Në këtë pjesë, interpretimi i normave ligjore është konkrete dhe i integruar me vlerësimin e faktit të provuar në gjykim, në rrjedhë logjike lidhur me evidentimin e elementëve të veprave penale për të cilat procedohet.

Gjyqtari ka referuar dhe interpretuar në mënyrë të hollësishme dhe të shkurtuar, sipas rastit, dispozita të veçanta të ligjit procedural penal gjykimin e shkurtuar dhe kushtet e aplikimit të tij (dosja 1, 2, 3, 4,6, 7, 8, 9, 10, 11), kufijtë e shqyrtimit të çështjes në rastet e kthimit për rigjykim mbi ankimin e të pandehurit së bashku me aplikimin e parimit të mos rëndimit të pozitës së të pandehurit (vendimi 1), kushtet për vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit të verifikuar (dosja 5) etj. Në çdo rast dispozitat e procedural penal citohen dhe zbatohen drejtpërdrejt në mbështetje të vendimmarrjes së gjykatës në raport me zbatimin e tyre apo në mbështetje të rrethanave specifike procedurale në të cilat ato gjejnë zbatim. Në disa raste në të cilat ka qenë e nevojshme, dispozitat procedurale, përveç citimit dhe referimit, janë shoqëruar me interpretim të zgjeruar të kuptimit të tyre (vendimi 1).

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në pjesën më të madhe të vendimeve citohen dhe interpretohen dispozita të Kodit Penal të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet si dhe të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal të cilat janë vlerësuar me vend për t’u marrë në analizë në mbështetje të arsyetimit të vendimit.

Kryesisht dispozitat e pjesës së përgjithshme të ligjit penal material interpretohen në mënyrë të integruar me faktet e provuara në gjykim, në lidhje me bashkëpunimin e thjeshtë (dosja 7, dosja 10), format e veçanta të bashkëpunimit (vendimi 1), tentativën dhe përgjegjësinë penale për veprat e mbetura në këtë fazë (dosja 1, dosja 2, dosja 7, dosja 8, dosja 9, dosja 11), heqjen dorë nga kryerja e veprës penale (dosja 10), dashjen si formë e fajësisë (dosja 4), mënyrën e caktimit të dënimit, rrethanat rënduese dhe lehtësuese që ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe masë së dënimit, uljen e dënimit nën minimumin e parashikuar nga ligji (dosja 4), kushtet për caktimin e dënimit me burgim për të pandehurin e mitur (dosja 10), kushtet e aplikimit të alternativave të dënimit me burgim, posaçërisht atë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal dhe detyrimet e të dënuarit të vënë në provë sipas parashikimeve të nenit 60 të këtij Kodi (dosja 10).

Dispozitat e ligjit penal material janë interpretuar në çdo rast të ndërthurura me faktet e provuara në gjykim, në shërbim të konkluzioneve të gjykatës lidhur me elementë të ndryshëm të faktit penal, elementë të ekzistencës së veprës penale, përgjegjësinë penale të të pandehurve në raport me veprat për të cilat procedohen, caktimin e llojit dhe masës së dënimit për secilin të pandehur në raport me kushtet dhe rrethanat specifike të tij, etj. Në tërësi, interpretimi ligjor i dispozitave të ligjit material nuk është kryer në mënyrë të veçuar dhe në aspektin teorik, por gjithmonë i integruar me rrethanat e faktit të provuara në gjykim apo pretendimet e palëve në lidhje me zbatimin e dispozitave të veçanta të ligjit procedural dhe material (vendimi 3, dosja 4).

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, janë respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor dhe në disa raste janë zbatuar edhe parime të tjera të procesit penal të tilla si veprimi në kohë i ligjit penal parashikuar nga neni 3 i K. Penal (vendimi 1 në të cilin analizohet dhe zbatohet neni 3 i Kodit Penal në lidhje me masën e dënimit për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal), parimi i mos rëndimit të pozitës së të pandehurit në rastet e rigjyqimit për shkak të ankimit të të pandehurit (vendimi 1 në të cilin interpretohet dhe zbatohet parimin i mos rëndimit të pozitës së të pandehurit, në këtë rast në lidhje me masën e dënimit, në respektim të parashikimeve të nenit 425/3, të Kodit të Procedurës Penale dhe vendimit unifikues nr. 2, datë 06.02.2009).

Evidentohet aftësia e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë në lidhje me arsyet e aplikimit të procedimit me gjykim të shkurtuar (Dosja 1, 2, 3, 4, 7, 8, 9, 10, 11 dhe Vendimi 1). Në këto raste gjyqtari referon, së bashku me bazën ligjore, edhe vendimin unifikues nr. 2/2003.

Gjithashtu në një rast referohet, citohet dhe analizohet konkluzioni i vendimit unifikues nr.4, datë 15.4.2011 një lidhje me përgjegjësinë penale në rastin e bashkëpunëtorit të paidentifikuar (dosja 7) si dhe në një rast tjetër gjyqtari i referohet konkluzioneve të vendimit unifikues nr. 5, datë 11.11.2003 në lidhje me përcaktimin e “pasojës së rëndë” si rrethanë cilësuese e veprës penale (vendimi 1).

Përveç jurisprudencës unifikuese të Gjykatës së Lartë, në një rast (dosja 9) gjyqtari ka referuar qëndrimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë lidhur me qëllimin e veprës penale të “Trafikimit të armëve” parashikuar nga neni 278/a/1 i Kodit Penal, si element i qenësishëm për ekzistencën e kësaj vepre penale. Sjellja dhe analizimi i këtij qëndrimi të Kolegjit Penal vjen në mbështetje të konkluzionit të gjykatës për mungesën e provueshmërisë së qëllimit të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, më pasojë ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal sipas parashikimeve të nenit 375 të K.Pr.P (referohet qëndrimi i mbajtur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 202, datë 11.7.2012).

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, identifikon dhe referon në praktikën unifikuese dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të arsyesimit të vendimeve.

.....

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.B. ARSYETIMILIGJOR**

### **1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit;

Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :”*Subjekti i rivlerësimit {...} harton vendime me strukturë të standardizuar. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë kërkesat e ligjit procedural penal. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët gjatë gjykimit. Analiza ligjore është e thjeshtë duke paraqitur normën penale të zbatueshme dhe duke dhënë arsyet pse ajo zbatohet në rastin konkret. Në tekstet e vendimeve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari...Struktura e vendimeve është e standardizuar. Ajo përmban në mënyrë të përgjithshme elementët e kërkuar nga legjislacioni procedural penal dhe civil....Respekton rregullat e drejtshkrimit, janë përdorur rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe...fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme. Dispozitivi është i qartë. Duhet evidentuar se kompleksiteti i çështjeve penale për krime të rënda është një fakto që ka ndikuar në strukturën dhe qartësinë e vendimit.. ”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Gjuha e përdorur nga gjyqtari në vendimet përfundimtare dhe në aktet procedurale të dosjeve të analizuar është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme.

Mënyra e organizimit të arsyetimit të vendimeve dhe përdorimit të gjuhës, në të gjitha aktet e marra në shqyrtim, reflekton qartësi në mënyrën e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, organizim dhe shprehje të mendimit sipas në rrjedhe logjike dhe të qartë për lexuesin e akteve. Nuk rezulton të jenë përdorur terma teknikë apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Në aktet e vëzhguara rezulton të jenë përdorur të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, janë respektuar rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës. Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare, të kuptueshme, të lidhura në rrjedhë logjike me njëra tjetrën. Po ashtu paragrafët me njëri-tjetrin

organizohen në rrjedhë logjike dhe nuk krijojnë shkëputje të arsytimit, brenda së njëjtës nëndarje të arsytimit të vendimit.

Në një rast gjyqtari i ka kushtuar rëndësi terminologjisë së ligjit dhe dhënies së kuptimit të tij në raport me termin “rekrutim” si formë e kryerjes së veprës penale të trafikimit (vendimi 2), duke sjellë në mbështetje të arsytimit të vendimit kuptimin e këtij termi sipas Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore”.

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira të arsytimit ligjor në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

#### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

### **1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së lidhur me këtë tregues, konkludohet se :” *Subjekti i rivlerësimit {...} harton vendime me strukturë të standardizuar, vendimet përfundimtare të tij plotësojnë kërkesat e ligjit procedural penal, arsytimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët në gjykim. Analiza ligjore është e thjeshtë, duke paraqitur normën penale të zbatueshme dhe dhënë arsye pse ajo zbatohet në rastin konkret. Në tekstet e vendimeve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari....”.*

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumentave ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një



⋮  
vendimi gjyqësor, çka i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Vendimet përfundimtare të gjyqtarit janë të organizuara sipas një strukture standarde, përveç dosjes 5, e cila ka të bëjë me verifikimin e zbatimit të masës së sigurimit dhe disponimi i gjykatës në këtë rast është materializuar në procesverbalin e seancës së verifikimit dhe jo në një vendim me vete, si dhe vendimit 3, në të cilin struktura e vendimit është e ndryshme, për shkak të natyrës së posaçme të çështjes, e cila ka të bëjë me kërkesën për konfiskimin e pasurisë në bazë të ligjit antimafia.

Struktura e vendimeve kryesisht ndjek ndarjen në tri pjesët kryesore të vendimit, sipas parashikimeve të nenit 383, të Kodit të Procedurës Penale.

Pjesa hyrëse e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë ose objektin e kërkesës dhe nenet përkatëse të Kodit Penal ose ligjeve të posaçme në rastin e çështjeve me objekt specifik (ligji antimafia), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese- arsyetuese e vendimeve ndjek gjithashtu një strukturë standarde, e organizuar në nëndarje, të cilat titullohen duke orientuar lexuesin për përmbajtjen e tyre. Pjesa përshkuese –arsyetuese fillon me një nëndarje të titulluar : “Hetimet Paraprake”, ku evidentohen rrethanat e faktit siç rezultojnë nga hetimi paraprak, pavarësisht ritit të gjykimit, gjykim i zakonshëm apo gjykim i shkurtuar. Në vijim të strukturës, në nëndarjen “Shqyrtimi gjyqësor”, evidentohen dhe analizohen elementë procedurale të tillë si kompetenca e gjykatës, gjykimi i shkurtuar....etj. Ndarja e tretë e strukturës titullohet “Rrethanat e faktit”, ku gjyqtari përshkruan rrethanat e faktit siç kanë rezultuar të provuara në gjykim. Në vijim në nëndarjen “Ligji i zbatueshëm” pasqyrohen vetëm tekstet e dispozitave mbi të cilin gjyqtari bazon vendimin e tij, pa bërë një analizë të pavarur të tyre nga faktet objekt shqyrtimi. Nëndarja pasuese e strukturës titullohet “Arsyetimi i gjykatës”, ku gjyqtari iu rikthehet edhe një herë fakteve, duke nxjerrë provueshmërinë e tyre tashmë nga analiza e provave. Gjyqtari veçon faktet e vlerësuara të rëndësishme për tu analizuar dhe përcakton në mënyrë specifike provat që mbështesin secilin prej tyre. Pjesa e fundit i përket individualizimit të dënimit.

Në disa nga vendimet e analizuara, referuar natyrës së çështjesh, veç nëndarjeve të pjesës arsyetuese si më sipër, evidentohen edhe nëndarje të tjera në të cilat analizohen, sipas rastit, kompetenca e gjykatës, pretendimet e palëve, analiza e veçantë e secilës veprës penale,

.....  
konkurenca e normave të ligjit penal, përfundimet e arritura nga analiza e provave etj (vendimi 1, vendimi 2 dhe vendimi 3). Në disa vendime, janë parashtruar në një nënndarje të veçantë të arsyetimit pretendimet e palëve (dosja 4 dhe vendimi 3), pjesë kjo e cila është vendosur në fund të pjesës përshkruese arsyetuese të vendimeve përkatëse.

Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të qartë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurve, akuzën përkatëse, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, bashkimin e dënimeve dhe uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar kur është aplikuar, kohën e fillimit të llogaritjes së tij, institucionin e vuajtjes së dënimit, disponimin për provat materiale, shpenzimet procedurale si dhe disponimin për ngarkimin e prokurorisë për ekzekutimit si dhe të drejtën e ankimit. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e plotë, e thjeshtë dhe e kuptueshme duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me të gjithë elementët e disponimit në vendimin përfundimtar penal.

Në rastin e disponimit për kërkesën e prokurorisë për konfiskimin e pasurisë, si një lloj i veçantë procedimi dhe vendimmarrje, vendimi është sërish i organizuar sipas një strukture të qartë dhe të kuptueshme, të organizuar në paragrafë të cilët qëndrojnë të ndarë dhe titulluar sipas përmbajtjes. Për shkak të natyrës së veçantë të procedimit dhe vendimit, i kushtohet rëndësi organizimit të analizës së gjykatës në ndarje të veçanta që analizojnë natyrën e hetimit pasuror, konceptim dhe kuptimin e konfiskimit, analizës së pretendimeve të palëve, etj. Në këtë rast dispozitivi i vendimit përmban disponimet e plota sipas përcaktimeve të ligjit të posaçëm nr. 10192, posaçërisht neneve 26 dhe 27 të tij që përcaktojnë elementët e vendimit të gjykatës për konfiskimin e pasurisë.

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se metodologjia e përdorur nga gjyqtari në copëzimin në nënndarje të vendimit gjyqësor, edhe pse në dukje shfaqet si një strukturë standarde dhe e qëndrueshme e përdorur prej tij, jo gjithmonë orjenton lexuesin drejt kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit. Jo gjithmonë pjesët e vendimit gjyqësor kanë një lidhje logjike, nga njëra nëndarje tek tjetra. Ndarja nga gjyqtari e pjesës përshkruese-arsyetuese sipas rrjedhës kronologjike të veprimeve procedurale, herë-herë me përsëritje të panevojshme, zbeh rrjedhën logjike të të analizës ligjore edhe pse ajo ekziston.

Për sa më sipër aftësia e gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi vlerësohet “mbi mesatare” duke u pikëzuar me 8 (tetë) pikë.

#### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” është “mbi mesataren” duke u pikëzuar me 8 pikë.*

⋮

### 1.B.C. ÇILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :*“..Niveli i arsytimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është evidentuar në asnjë rast në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara që të jenë cenuar nga gjykatat më të larta, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, tek 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme. Vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsytimi, duke referuar qartë shkakun dhe bazën ligjore....”*.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Në arsytimin e vendimit gjyqtarit i duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve proceduriale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.

Gjyqtari në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e faktit penal objekt shqyrtimi duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit penal apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), argumentet e gjykatës shtjellohen në mënyrë logjike, duke u integruar me faktet e provuara në gjykim dhe duke u ndalur herë pas here, në analizën e të dispozitave ligjore, posaçërisht në lidhje me bashkëpunimin si rrethanë cilësuese ose rënduese, format e veçanta të bashkëpunimit, kuptimin e tentativës, kuptimin e trafikimit dhe format e kryerjes së tij, kuptimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë në rastin e procedimeve pasurore, etj.

Në vendimet gjyqësore gjyqtari i kushton shumë rëndësi analizës së provave në drejtim të provueshmërisë së faktit penal dhe autorit të veprës penale. Analiza është e detajuar, si në drejtim të provave që provojnë fajësinë, ashtu dhe atyre të kundërta. Argumentimi logjik i gjyqtarit në drejtim të identifikimit të marrëdhënies shkak-pasojë, si në procedimet penale ashtu edhe në atë të posaçëm siç është konfiskimi i pasurisë, organizohet në mënyrë të qartë të

.....  
kuptueshme dhe ka vijueshmëri. Konkretisht gjyqtari jo vetëm i pasqyron provat, por bën vlerësim të tyre si në drejtim të provueshmërisë së faktit përkatës ashtu dhe në drejtim të lidhjes së veprimeve/mosveprimeve të të pandehurit me elementë që kanë rëndësi për cilësimin juridik të veprës penale.

Ajo që konstatohet lehtësisht në vendimet gjyqësore është cilësia e lartë e argumentimit logjik si veshje e gjithë procesit të të provuarit të fakteve në gjykim. I njëjti standart cilesie argumentimi konstatohet edhe kur është fjala për cilësimin juridik të fakteve, ku argumentimi logjik bazohet jo vetëm në qëndrime të mirëpranuara, por edhe në analizën ligjore, pavarësisht se gjyqtari jo gjithmonë bën analizë të pavarur të ligjit material të zbatueshëm mbi faktet objekt gjykimi. Analiza ligjore për lidhjen e faktit me akuzën e ngritur apo për ndryshimin e cilësimit juridik të tij, mbështetet si në procesin e të provuarit, ashtu edhe në interpretimin e dispozitave penale.

Në rastin e kërkesave për konfiskimin e pasurisë (vendimi 3) analiza e ligjit dhe e faktit është bërë mbi bazën e një zhvillimin logjik të koncepteve ligjore sipas ligjit të posaçëm (Ligji nr. 10 192, datë 03.12.2009), duke u analizuar veçanërisht fusha e zbatimit të ligjit, autonomia e procedimit pasuror nga procedimi penal, niveli i dyshimit të arsyeshëm për përfshirjen e të paditurit në aktivitetin kriminal nga i cili dyshohet të jenë gjeneruar pasuritë objekt kërkimi, kuptimi dhe qëllimi i sekuestrimit dhe konfiskimit, legjitimiteti i personit të tretë, analiza lidhur me barrën e provës dhe mungesën e provueshmërisë së origjinës së ligjshme të pasurisë për të cilën kërkohet konfiskimi, analiza e faktit lidhur me origjinën e pasurisë që kërkohet të konfiskohet. Një pjesë e posaçme e arsytimit të vendimit i kushtohet analizës lidhur me pretendimin e mbrojtjes për cenim të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ dhe neneve 11/2 dhe 41/1 të Kushtetutës. Analiza e gjyqtarit lidhur me këtë pretendim, duke risjellë në vëmendje qëllimin dhe fushën e zbatimit të ligjit të posaçëm antimafia, sjell si konkluzion logjik vlerësimin se nuk ka cenim të të drejtave kushtetuese të pretenduara nga mbrojtja e palës së paditur nëpërmjet zbatimit të ligjit të posaçëm antimafia.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, gjyqtari përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve nëpërmjet argumenteve të integruara në pjesën e “vlerësimit të gjykatës”, dhe në disa raste në një pjesë të veçantë të arsytimit të vendimit. Në dy raste (dosja 4 dhe vendimi 3) analiza e pretendimeve të mbrojtjes është bërë në fund të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, pasi gjykata ka analizuar dhe konkluduar lidhur me faktin penal, provueshmërinë dhe kualifikimin ligjor të tij, megjithatë në të dy këto raste, në këtë pjesë të arsytimit pretendimet e palëve në lidhje me faktin dhe ligjin janë analizuar në mënyrë të plotë duke risjellë në arsyetim elementë të faktit penal të provuar në gjykim në shërbim të vlerësimit të kërkimeve të mbrojtjes së të pandehurit (dosja 4) apo elementë të analizës dhe kuptimit të ligjit në shërbim të vlerësimit lidhur me kërkimet e mbrojtjes së të paditurit për cenim të dispozitave kushtetuese apo nenit 1, të Protokollit 1, të KEDNJ, nga zbatimi i ligjit antimafia (vendimi 3).

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, në të gjitha vendimet e analizuar rezultojnë një nivel arsytimi i plotë dhe i qartë, ku shqyrtohet dhe argumentohet çdo element të diskutueshëm në raport me faktin penal,

⋮  
kualifikimim ligjor të tij apo elementë të tjerë të nevojshëm për tu analizuar në raport me aspektet procedurale të zhvillimit të gjykimit. Argumentimi logjik i gjyqtarit krijon një përmbajtje koherente brenda vendimit, pa kundërthënie, analizë mbi të cilën mbështetet pjesa urdhëruese e vendimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.*

**Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”**

Niveli i vlerësimit AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98

**2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

**2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË**

**2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :”Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...} ka qenë e shpejtë, në intervale kohore nga 1 ditë deri në 2 muaj e 23 ditë. Në tre dosjet e tjera kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 12 ditë, 2 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 20 ditë. Në të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se është respektuar afati ligjor apo ai

standard i gjykimit. Gjykimi brenda afateve është konstatuar edhe tek tre dokumentet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, ku është analizuar data e regjistrimit të çështjes në gjykatë në raport me datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Kështu, kohëzgjatja e gjykimit në këto 3 raste ka qënë 3 muaj ( dokumenti 1), 5 muaj e 10 ditë (dokumenti 2) dhe 8 muaj e 14 ditë (dokumenti 3).”

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues rezulton se:***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Ndërkohë për shqyrtimin e kërkesave të fazës së hetimeve paraprake dhe kërkesave për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë, në bazë të ligjit të posaçëm, parashikohen afate ligjore gjykimi.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për dy prej tyre (dosja 5 dhe vendimi 3) ligji procedural ka parashikuar afat ligjor shqyrtimi. Konkretisht për kërkesat penale me objekt “Ekzekutim i masës së sigurimit”, neni 248 i Kodit të Procedurës Penale parashikon verifikimin e zbatimit të masës brenda afatit 3 ditor nga momenti i zbatimit. Në rastin konkret (Dosja 5) seanca gjyqësore është planifikuar dhe zhvilluar brenda ditës në të cilën kërkesa është regjistruar në gjykatë dhe njëkohësisht duke respektuar afatin ligjor tre ditor nga momenti i ekzekutimit të masës sipas nenit 248 pika 1 të K.Pr.P<sup>11</sup>.

Në rastin e kërkesave për konfiskimin e pasurisë, neni 23 i Ligjit nr. 10192 datë 3.12.2009, parashikon shqyrtimin e tyre brenda tre muajve nga data e paraqitjes së kërkesës në gjykatë dhe në çdo rast, jo më vonë se një vit nga data e paraqitjes së kërkesës, në rastin e çështjeve komplekse. Në rastin konkret (vendimi 3) gjykimi ka zgjatur 8 muaj e 18 ditë, duke përfunduar brenda afatit ligjor një vjeçar të parashikuar në nenin 23 pika 2 të Ligjit nr. 10192, sipas parashikimeve të këtij Ligji në kohën e zhvillimit të gjykimit.

Për sa më sipër, duke iu referuar dy çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore shqyrtimi, rezulton se këto afate janë respektuar. Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar dy çështjeve të analizuara më sipër në të cilat afati ligjor i gjykimit është respektuar, ky kriter, do të pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

---

<sup>11</sup> Shih dosjen 5.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë pasi nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit.*

## **2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :”Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...} ka qenë e shpejtë, në intervale kohore nga 1 ditë deri në 2 muaj e 23 ditë. Në tre dosjet e tjera kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 12 ditë, 2 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 20 ditë. Në të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se është respektuar afati ligjor apo ai standard i gjykimit. Gjykimi brenda afateve është konstatuar edhe tek tre dokumentet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, ku është analizuar data e regjistrimit të çështjes në gjykatë në raport me datën e dhënies së vendimit përfundimtar. Kështu, kohëzgjatja e gjykimit në këto 3 raste ka qenë 3 muaj ( dokumenti 1), 5 muaj e 10 ditë (dokumenti 2) dhe 8 muaj e 14 ditë (dokumenti 3).”.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues rezulton se:***

Për 10 çështjet e vëzhguara, për të cilat nuk parashikohet afati ligjor gjykimi dhe 2 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas Vendimit nr.261/2 të KLD<sup>12</sup>. Gjykimi për çështjet e përzgjedhura me short ka zgjatur nga

<sup>12</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se :” Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo me tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.”.

1 muaj e 3 ditë minimalisht, në 6 muaj e 3 ditë maksimalisht, por në çdo rast brenda standardit minimal kohor.

Në 2 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, gjykimi ka zgatur përkatësisht 3 muaj dhe 5 muaj e 10 ditë, duke respektuar standardin minimal kohor të përcaktuar dhe për pasojë, nuk rezulton asnjë çështje e shqyrtuar jashtë këtij standardi.

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar plotësisht në të gjitha çështjet e analizuar.

#### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi nuk ka çështje të gjykuara jashtë standardit minimal kohor.*

### **2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

*Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të KLGJ nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.*

#### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues rezulton se:***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykata e posaçme (Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në periudhën e vlerësimit). Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 2 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit<sup>13</sup>.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje në raport me standardin minimal kohor për kategori (të gjitha çështjet e marra në analizë janë çështje penale krime), për 10

<sup>13</sup> Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.”.



çështjet e përzgjedhura me short dhe 2 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë rreth 85 ditë ose rreth 2 muaj e 25 ditë<sup>14</sup>. Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është dukshëm më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale të themelit në gjykatat e shkallës së parë, për të gjitha çështjet e kësaj kategorie.

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

#### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor.*

#### **2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “...Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këtë të dhëna është 96.4 %.”.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues rezulton se:***

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit<sup>15</sup>, gjyqtarit {...}, në gjithë periudhën e vlerësimit i janë caktuar në cilësinë e kryesuesit 58 çështje penale themeli, 57 kërkesa penale administrative, 105 çështje kërkesa penale te hetimit paraprak dhe 7 kërkesa të tjera penale (sekuestrim dhe konfiskim pasurie), në total 227 çështje. Në vitin 2016 ka mbartur 3 çështje për vitin 2017 (sipas Raportit të analizimit të aftësive profesionale, faqe 28). Ndërkohë rezulton se ka përfunduar, në gjithë periudhën e vlerësimit, 163 çështje në total.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit si dhe mospërputhje të numrit të çështjeve të përfunduara në bazë të të dhënave statistikore me të dhënat e pasqyruara në Raportin e analizimit të aftësive

<sup>14</sup> Kohëzgjatja mesatare e gjykimit për 12 çështje gjyqësore, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e gjykimit për 2 nga 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari.

<sup>15</sup> Tabelat me të dhëna statistikore të administruara në faqen 88 deri 93 të dosjes së rivlerësimit

profesionale, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje. Për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 96.4 % i përcaktuar në faqen 28 të Raportit, faqe 611 i dosjes së rivlerësimit.

#### KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit tetor 2013- tetor 2016, rezulton në masën 96.4 %.

#### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtari pikëzohet me 8 pikë pasi ky rendiment është në masën 96.4 %.*

### **2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR**

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short në procesin e rivlerësimit);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: “..Gjyqtari {...} i kushton rëndësi arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve. Pesë vendimet gjyqësore janë arsyetuar brenda afatit 5 ditor të parashikuar nga neni 113 i K.Pr.P...”. Nga analiza e burimeve të vlerësimit, evidentuar dhe përshkruar në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, dhe më sipër në raportin e vlerësimit, rezulton se:

⋮

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues rezulton se:***

Sipas Raportit për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së dhe akteve të dosjes së vlerësimit, rezulton se:

- Dosja 1, që i përket vendimit nr. 72, datë 19.6.2014 është dorëzuar më datë 20.6.2014 (1 ditë);
- Dosja 2, që i përket vendimit nr.113, datë 2.10.2014 është dorëzuar më datë 3.10.2014 (1 ditë);
- Dosja 3, që i përket vendimit nr.132, datë 24.6.2015 është dorëzuar më datë 28.9.2015 (3 ditë);
- Dosja 4, që i përket vendimit nr. 49, datë 12.4.2016 është dorëzuar më datë 15.4.2016 (3 ditë);
- Dosja 5, që i përket vendimit nr.430, datë 15.10.2015 është dorëzuar më datë 20.10.2015 (5 ditë);

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 10.6.2020, lidhur me 6 dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 27.7.2020, rezulton se:

- Dosja që i përket vendimit me nr. 46, datë 7.4.2016 është dorëzuar më datë 8.4.2016 (1 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 112, datë 27.4.2016 është dorëzuar më datë 28.9.2016 (1 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 111, datë 12.10.2015 është dorëzuar më datë 13.10.2015 (1 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 96, datë 28.7.2015 është dorëzuar më datë 30.7.2015 (2 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 83, datë 8.7.2014 është dorëzuar më datë 10.7.2014 (2 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 43, datë 3.4.2014 është dorëzuar më datë 4.4.2014 (1 ditë).

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit për kategorinë “kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak” (dosja 5) është 5 ditë. Për kategorinë “penale krime” koha mesatare e dorëzimit të vendimit gjyqësor të arsyetuar është 1.6 ditë.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10/ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10/ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë. Duke qenë se koha mesatare e dorëzimit të vendimit të arsyetuar nga ana e gjyqtarit në rastin konkret, është 5 ditë për një kategori dhe 1.6 ditë për kategorinë tjetër, ajo është më e shkurtër se gjysma e afatit të ankimit, çka vlerësohet si një shkallë e lartë kujdesi që gjyqtari ka treguar për arsyetimin në kohë të vendimeve.

**KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

...

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.**

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

## **2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE**

### **2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “..Gjyqtari {...}, ka kryer veprimet e nevojshme për seancën gjyqësore, ...numri i seancave në çështjet e themelit ka qenë i ndryshëm. Kështu, dosja 5 ka përfunduar me 1 seancë produktive, dosjet 2 dhe 3 kanë përfunduar me 3 seanca, nga 1 seancë jo produktive dhe 2 produktive, dosja 1 ka përfunduar me 5 seanca...dosja 4 ka përfunduar me 8 seanca... Këto të dhëna tregojnë se nga 20 seanca gjyqësore të vëzhguara, 9 prej tyre kanë qenë jo produktive...”.

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues rezulton se:**

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, 10 prej tyre janë çështje me palë kundërshtare dhe i përkasin kategorive “penale krime” dhe “konfiskim pasurie”. Lidhur me numrin e seancave gjyqësore, rezulton si më poshtë:

**Në çështjet e përzgjedhura me short administruar në dosjen e rivlerësimit:**

**Dosja 1**, çështja me nr. regjistri 92, datë regjistrimi 2.5.2014, nr. vendimi 72, datë vendimi 19.6.2014. Janë zhvilluar **5 seanca gjyqësore** të dokumentuara nëpërmjet regjistrimit në sistem audio, nga të cilat 1 jo produktive dhe 4 produktive;

**Dosja 2**, çështja me nr. regjistri 144, datë regjistrimi 27.7.2014, nr. vendimi 113, datë vendimi 2.10.2014. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, nga të cilat 1 joproductive dhe 2 produktive.

**Dosja 3**, çështja me nr. regjistri 132, datë regjistrimi 24.6.2015, nr. vendimi 3096, datë vendimi 25.9.2015. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore** nga të cilat 1 joproductive dhe 2 produktive.

**Dosja 4**, çështja me nr. regjistri 85, datë regjistrimi 19.1.2016, nr. vendimi 49, datë vendimi 12.4.2016. Janë zhvilluar **8 seanca gjyqësore** nga të cilat 3 produktive dhe 5 joproductive;

**Dosja 5**, çështja me nr. regjistri 430, datë regjistrimi 15.10.2015, nr. vendimi 430, datë regjistrimi 15.10.2015. Është zhvilluar **1 seancë gjyqësore** e cila ka qenë produktive. Kjo

çështje, duke qenë e kategorisë “ kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak”, klasifikohet si çështje pa palë kundërshtare dhe për këtë arsye nuk merret në konsideratë për përlogaritjen dhe vlerësimin e këtij treguesi.

#### **Në çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit:**

**Dosja 6**, çështja me nr. regjistri 105, datë regjistrimi 5.6.2014, nr. vendimi 83, datë vendimi 8.7.2014. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, nuk ka seanca jo produktive.

**Dosja 7**, çështja me nr. regjistri 56, datë regjistrimi 30.1.2014, nr. vendimi 43, datë vendimi 3.4.2014. Janë zhvilluar gjithsej **7 seanca gjyqësore** nga të cilat 4 kanë qenë jo produktive. Një seancë nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues ndërsa tre të tjera për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësve ose prokurorit. Shkaqet e shtyrjes së seancave janë relatuar nga gjykata si dhe rezultojnë të jenë marrë masa efektive për të garantuar zhvillimin e gjykimit në seancën vijues (*masa të tilla si njoftimi drejtuesit të prokurorisë, njoftimi i të dy mbrojtësve të të pandehurit, pezullimi i afateve të paraburgimit*).

**Dosja 8**, çështja me nr. regjistri 94, datë regjistrimi 7.4.2015, nr. vendimi 96, datë vendimi 10.9.2015. Janë zhvilluar gjithsej **12 seanca gjyqësore** nga të cilat 9 kanë qenë jo produktive. Seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale të përligjura dhe rezultojnë qenë çdo rast gjykata ka marrë gjithë masat e nevojshme për të siguruar vijimin e gjykimit në seancën vijuese (*masa të tilla si njoftimi i të pandehurve npm policisë gjyqësore, caktimi avokatit kryesisht, marrja e masave për shoqërimin e të pandehurve në seancë, njoftimi i Dhomës së Avokatisë për shkak shtyrjes së gjykimit si pasojë e mosparaqitjes së avokatit, pezullimi i afateve të paraburgimit*).

**Dosja 9**, çështja me nr. 148 regjistri, datë regjistrimi 20.7.2015, nr. vendimi nr. 111, datë 12.10.2015. Janë zhvilluar gjithsej **4 seanca gjyqësore** nga të cilat 2 kanë qenë jo produktive. Seancat nuk janë zhvilluar ose janë shtyrë për shkaqe procedurale të përligjura (*mosparaqitja e prokurorit dhe mbrojtësit, mos formimi i trupit gjykues, dhënia kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim*) dhe rezultojnë qenë çdo rast gjykata ka marrë gjithë masat e nevojshme për të siguruar vijimin e gjykimit në seancën vijuese.

**Dosja 10**, çështja me nr. 155 regjistri, datë regjistrimi 27.7.2016, nr. 112, datë 27.9.2016. Janë zhvilluar gjithsej **2 seanca gjyqësore** produktive. Seanca e parë është shtyrë për ti lënë kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim.

**Dosja 11**, çështja me nr. regjistri nr. 97 regjistri, datë regjistrimi 22.2.2016, nr. 46, datë 7.4.2016. Janë zhvilluar gjithsej **3 seanca gjyqësore** dhe nuk rezultojnë seanca jo produktive.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezultojnë se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në çështjet e vëzhguara variojnë nga 2 deri në 12 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 10 çështjeve të vëzhguara, rezultojnë të jetë 5 seanca.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short (çështje themeli ma palë) rezultojnë se gjyqtari ka marrë të gjitha masat procedurale për menaxhimin me efektivitet të ecurisë së procesit, ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë, pavarësisht numrit të lartë të të pandehurve dhe mbrojtësve respektive, për

shkak të natyrës së çështjeve, që ka sjellë si pasojë zhvillimin e një numri të lartë seancash në disa raste.

Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues apo angazhimit të anëtarëve të trupit gjykues në aktivitete pune, rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë shumë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit. Në të gjitha rastet e tjera shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si njoftimit njoftimi i të pandehurve për të dhënë pëlqimin për procedimin me gjykim të shkurtuar, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurve, njoftimi për të marrë pjesë i prokurorit etj. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.P.

Referuar sa më sipër, për treguesin “numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 10 çështjeve<sup>16</sup> të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është **5 seanca** dhe gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

#### KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi, është e lartë dhe për këtë shkak, gjyqtari duhet të vlerësohet me 15 pikë.

#### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuar, nuk ka ardhur për shkaqe të cilat janë përgjegjësi e gjyqtarit.*

## **2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;

<sup>16</sup> Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse”. Për këtë arsye numri i seancave për Dosjen 5 nuk përlllogaritet në këtë tregues duke qenë se ajo bën pjesë në kategoritë e çështjeve që konsiderohen pa palë kundërshtare, me efekt vlerësimi.

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Gjyqtari {...} ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për seancën gjyqësore, duke identifikuar saktësisht palët pjesëmarrëse për njoftimin në kohën e duhur. Në çeljen e seancave përgjithësisht ka patur vonesa 30 minuta në dosjen...40 minuta...etj. Megjithatë vonesa në fillimin e çeljes së seancave nuk ka shkaktuar dështimin e tyre. Të pesë çështjet e vëzhguara janë dokumentuar me regjistrim audio. Gjatë gjykimi ai identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutime [përfundimtar gjer te shpallja e vendimit.”.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues rezulton se:***

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtare dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak. Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, rezulton si më poshtë:

Gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës së parë gjyqësore në çdo rast 1 deri 3 ditë pas caktimit të çështjes me short dhe në të njëjtën ditë me nxjerrjen e urdhrat të Kryetarit për formimin e trupit gjykues, duke respektuar afatin procedural 10 ditor të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale.

Seancat gjyqësore për 10 dosjet që i përkasin çështjeve të themelit, seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.P, përveç rasteve të periudhës së lejes në muajin Gusht<sup>17</sup>, të cilat përbëjnë të vetmet raste të tejkalimit të afatit 15 ditor për caktimin e seancave në procesin penal. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës së prokurorisë në lidhje me zbatimin e masës së sigurimit (Dosja5) gjykata ka marrë masa efektive për të mundësuar planifikimin dhe zhvillimin brenda së njëjtës ditë të seancës, në po të njëjtën ditë të depozitimit të kërkesës në gjykatë, me qëllim respektimin e afatit ligjor të shqyrtimit sipas nenit 248 të K.Pr.P.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe të pasqyruar në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

<sup>17</sup> Dosja 3, 9, 10;

Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale të gjyqimit penal sipas parashikimeve të nenit 335 e vijues të K.Pr.P dhe 405 e vijues ne rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar. Gjatë zhvillimit të gjyqimit tregohet kujdes i posaçëm për të relatuar regjistrimin e seancës në sistem audio, relatimi i verifikimit të paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimi i akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjyqimit, marrjen e vendimeve për zhvillimin e gjyqimit në mungesë sipas parashikimeve të nenit 351 dhe 352 të K.Pr.P, sipas rastit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), administrimin e provave, dhënien fjalën palëve për diskutimin përfundimtar, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, shoqërimin e të pandehurve etj.).

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes *(në rastet e deponimit për kërkesat paraprake të palëve, zëvendësimin ose jo të mbrojtësve që nuk janë paraqitur, shtyrjen e seancave etj.)*.

Në dosje të vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesë me disa minuta, shoqëruar me relatimin e shkakut që ka shkaktuar vonesën në çeljen e seancës, por asnjëherë nuk rezulton që seancat të mos jenë zhvilluar për shkak të kësaj vonese.

#### KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjyqimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

#### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.*

## **2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE**

### **2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;



- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short u konstatua se ato përgjithësisht kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota.”.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve gjyqësore i bën ato lehtësisht të aksesueshme duke përmbajtur aktin e shortit, urdhrin e formimit të turpit gjykues, vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave sipas datave, diskutimet me shkrim të palëve dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta nën aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

#### KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

#### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.*

## **2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short u konstatua se ato përgjithësisht kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota..”.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seancë, vendimet gjyqësore) si dhe aktet e paraqitura nga palët (provat e administruara për herë të parë në seancë për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

#### KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### 3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë aspekt në raportin e KLGJ-së konkludohet se: “..Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit , për gjyqtarin {...} janë paraqitur gjithsej 3 ankesa në Inspektoratin e KLD-së. 2 ankesa të vitit 2014, verifikuar bazuar në raportin

periodik të vetë kryetarit në lidhje me vendimet e cenuara i janë regjistruar gjyqtarit për vlerësim etik dhe profesional. I ankesë e vitit 2015, verifikuar për mosrespektim formal të ligjit është në verifikim në vijim. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Ndërsa nga të dhënat e regjistrit për procedime disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit {...}. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt”.

### **3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e arritura në vendimin Nr.218 dt. 10.12.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i formës së prerë.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :*

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Lidhur me ankesat e trajtuara gjatë periudhës së vlerësimit, pas administrimit dhe vlerësimit të relacioneve për trajtimin e tyre nga Inspektorati i KLD, përshkruar më sipër në raportin e vlerësimit<sup>18</sup> rezulton se një ankesë lidhet me një vendim i cili është jashtë periudhës së vlerësimit (viti 2012) ndërsa dy vendimet e tjera i përkasin periudhës së vlerësimit dhe gjyqtari {...} ka pasur në to cilësinë e anëtarit të trupit gjykues.

Në raportet përkatëse të Inspektoratit të KLD rezulton se, shkak i referimit për t’u mbajtur në konsideratë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit ka qenë cënimi i vendimit nga gjykata më e lartë për mënyrën e zbatimit të ligjit në lidhje me parimin e ligjit penal favorizues (materiali 1), mënyrën e zbatimit të ligjit procedural në lidhje me mospranimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar (materiali 2) si dhe mënyrën e çmuarjes së provave dhe vlerës provuese të tyre në raport me fajësinë e të pandehurit (materiali 3). Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe analizuara në relacionet përkatëse, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cënimit të etikës, pasi ato referohen vetëm si fakt që ndikon në përqindjen e vendimeve të cenuara, të cilat nuk përbëjnë burim më vete vlerësimi. Në lidhje me materialin 3, në përfundim të trajtimit të së cilit është referuar çështja për tu marrë në konsideratë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit, konkluzioni i Inspektoratit i referohet meritave të

<sup>18</sup>Pika 7, faqe 10-14 e raportit.

çështjes, posaçërisht mënyrës së çmuarjes së provave, e cila nuk është objekt i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, në referim të parashikimeve të nenit 69 shkronja “a” dhe 72 pika 4 të Ligjit për Statusin.

Në të tre relacionit e hartuara nga Inspektorati i KLD-së nuk rezultojnë të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për gjyqtarin {...}, evidentohet vetëm një veprim i gjyqtarit, i cili në vlerësimin e Komisionit përbën shkelje etike nga ana e gjyqtarit, por jo aq e rëndë sa të shërbejë si shkak i mjaftueshëm për marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”. Konkretisht gjatë hetimit administrativ në kuadër të procesit të rivlerësimit ka rezultuar se gjyqtari {...}, kishte depozituar pranë Raiffeisen Bank sh.a për qëllim të përfitimit të kredisë edhe një deklaratë noteriale e dt. 08.09.2006 e nënshkruar nga babai i tij, në të cilën deklarohet se i kishte dhënë hua të birit shumën prej 5 000 000 lekë, pa afat kthimi dhe pa interesa. Këtë hua gjyqtari nuk e kishte deklaruar në asnjë deklaratë periodike dhe as në deklaratën “Vetting”. Lidhur me këtë situatë gjyqtari ka shpjeguar gjatë procesit të rivlerësimit se kjo deklaratë i është kërkuar nga “Raiffeisen Bank”, pasi më parë kjo bankë kishte shqyrtuar dhe analizuar formulimet në kontratën e sipërmarrjes të datës 26.7.2006 që subjekti kishte nënshkruar me shoqërinë “F.” sh.p.k., (më saktësisht, lidhur me formulimin e pagesës së çmimit prej 60.000 euro që kishin përcaktuar palët në kontratë). Gjyqtari ka shpjeguar se kjo deklaratë kishte edhe funksionin e një forme garancie ndaj babait të tij, i cili po vendoste barrë hipotekore ndaj banesës së tij për të garantuar kthimin e kredisë së bankës në favor të të birit. Gjyqtari ka deklaruar se nuk ka marrë asnjëherë asnjë shumë hua nga babai i tij, sipas deklaratës noteriale në fjalë, dhe se babai i tij nuk e ka disponuar asnjëherë shumën 5.000.000 lekë deri në datën e deklaratës.

Lidhur me situatën e mësipërme Komisioni është shprehur : “.....Për sa më sipër Komisioni çmon se deklarata noteriale e babait të subjektit të rivlerësimit, bashkëlidhur me dokumentacionin e “Raiffeisen Bank”, është deklaratë fiktive, dhe ka qenë pjesë e veprimeve të subjektit në përpjekjet e tij për të përfituar kredinë nga kjo bankë për qëllime strehimi (është fakt i provuar se shuma e kredisë së disbursuar e transferuar në llogarinë e një shoqërie ndërtuese për qëllim blerjen e pasurisë apartament banimi), në rrethanat e nevojës së tij për strehim, por pa ndikuar apo shfrytëzuar për këtë fakt pozitën e tij si magjistrat. Lidhur me këtë rrethanë, ndonëse është i padiskutueshëm fakti i përdorimit të një deklarate fiktive nga subjekti (i cili nuk ka qenë nënshkruar), duhet të mbahet në konsideratë një tjetër specifikë, që konsiston në mosqenien e kësaj deklarate e domosdoshme për arritjen e (qëllimit) të marrjes së kredisë. Kjo pasi – edhe pse banka kredidhënëse është bazuar edhe mbi këtë deklaratë, për aprovimin dhe lëvrimin e kredisë – shumë mirë subjekti i rivlerësimit mund të kishte marrë të njëjtën kredi (për sa kohë posedonte garancitë financiare), duke u mjaftuar vetëm përdorimi i kontratës së porosisë, me kushtin që në këtë të fundit të ishte pasqyruar realiteti, pra, që subjekti i detyrohej shoqërisë ndërtuese shumën e parashikuar si çmim të sendit objekt kontrate, ose edhe vetëm një pjesë të tij (të barabartë me kredinë e marrë). Për rrjedhojë, deklarata fiktive e përdorur vlerësohet më shumë si një veprim sipërfaqësor i pa menduar mirë, i kryer për plotësimin e

...

kërkesës specifike të bankës në fjalë, sesa një qëllim i planifikuar në detaje për të realizuar marrjen e kredisë në mënyrë të paligjshme, pasi kredia mund të ishte marrë edhe vetëm me modifikimin e kontratës së porosisë – duke e çuar përmbajtjen e saj drejt pasqyrimin të realitetit. Për sa kohë deklarata fiktive ka qenë e dobishme por jo e domosdoshme për qëllimin e arritur, kjo rrethanë rezulton më e lehtë se një manipulim i realitetit për përfitimin e diçkaje që nuk mund të arrihej me rrugë alternative. Për sa më lart, Komisioni çmon se përdorimi i një deklarate fiktive është një element që lidhet me anën etike të magjistratit, e cila në përfundim të gjyqimit, do të vlerësohet në tërësi dhe harmoni me të gjitha provat dhe rrethanat e tjera, që kanë rezultuar nga ky proces rivlerësimi...”

Në vijim Komisioni, pasi ka vlerësuar në tërësi dhe në harmoni me të gjitha provat, përdorimin nga gjyqtari të kësaj deklarate fiktive, ka konkluduar se : “.....Në rastin konkret përdorimi nga subjekti i rivlerësimit të një deklarate noteriale fiktive me babanë e tij, si dhe ekzistenca e nja balance të vogël në analizën financiare të subjektit gjatë periudhës së rivlerësimit, përbëjnë arsye të cilat nuk mund të konsiderohen si mënyrë sjellje e subjektit në kundërshtim me ligjin, që ka pasur si qëllim përfitimin e një të drejtë në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi. Subjekti në rastin konkret i përmbushte në mënyrë të qartë kriteret për përfitim të kredisë, nuk dispononte asnjë pasuri tjetër dhe për pasojë shkalla e shkëljes nga subjekti nuk mund të konsiderohet si një shkelje etike e rëndë, e vetmja në vlerësimin profesional të tij gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit si gjyqtar, e cila të shërbejë si shkak i mjaftueshëm për marrjen e një mase disiplinore për shkarkimin nga detyra. E njëjta logjikë, e bazuar në parimin e proporcionalitetit, vlen dhe duhet të përdoret në analizimin në harmoni të të gjitha kriterëve të këtij procesi rivlerësimi, përfshirë këtu edhe kriterin e pasurisë.....”.

Në kuadër të objektit të rivlerësimit kalimtar, pra të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale të kandidatit, në funksion të verifikimit të pasjes nga ai të një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, të një niveli të besueshëm në kontrollin e figurës, si dhe të një niveli minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, KPK pasi ka konstatuar rrethanat e mësipërme, ka vlerësuar se ato përbëjnë shkelje të etikës nga gjyqtari, por jo në atë masë sa mund të çojnë në shkarkimin e tij.

Lidhur me periudhën e rivlerësimit të aftësive profesionale, në Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Shqipërisë” parashikohet :

Neni 3 pika 12 : “Periudha e rivlerësimit” është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit, gjatë së cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij, sipas këtij ligji”.

Ndërsa në nenin 41 parashikohet : “...3. Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se 3 vite në detyrë, periudha e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelineve merr parasysh këto informacione nëse

⋮

relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit.

⋮

Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, në rastin konkret rivlerësimi i etikës, në kuadër të aftësive profesionale për gjyqtarin {...}, është shtrirë të paktën prej tetorit 2006, për shkak se gjatë procesit administrativ të kryer nga KPK, kanë rezultuar të dhëna të muajit tetor 2006, që janë analizuar dhe vlerësuar të domosdoshme në drejtim të rivlerësimit të etikës së gjyqtarit. Periudha e rivlerësimit në këtë rast, për efekt të vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit/gradimit, nuk është vetëm periudha 3/vjeçare 2013-2016, pasi sa i përket etikës ajo rezulton e shtrirë nga tetori 2006.

Në zbatim të nenit 171 pika 5 të Ligjit për Statusin, proçesi i gradimit që KLGJ duhet të fillojë me përparësi për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, përfshin çdo dokument të përdorur nga organet e rivlerësimit për vlerësimin e aftësive profesionale. Pavarësisht se periudha e vlerësimit etik dhe profesional (gradimi), si rregull, është 3/vjeçare, duke përfshirë vitet 2013-2016, ajo ndjek të njëjtën kohëzgjatje si periudha e rivlerësimit, për fakte të evidentuara nga organet e rivlerësimit që lidhen me etikën dhe veprimtarinë profesionale.

Sa më sipër, veprimet e gjyqtarit {...} të kryera në tetor 2006, duke qenë se janë përfshirë në procesin e rivlerësimit kalimtar për të, do të analizohen dhe vlerësohen në kuadër të procesit të gradimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për efekt të përcaktimit të nivelit të përgjithshëm të vlerësimit të gjyqtarit, ku “etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” përbën një nga katër kriteret e vlerësimit.

Por, KLGJ, në ushtrim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit, në funksion të përcaktimit të gradës/nivelit të vlerësimit, bën një vlerësim të pavarur të shkaqeve të evidentuara organet e rivlerësimit sa i përket fakteve në lidhje me etikën dhe shkallën e ndikimit të tyre në kuadër të këtij vlerësimi/gradimi. Në rastin konkret, Këshilli analizoi rrethanat e faktit dhe kohën e ndodhjes së tij, pikërisht veprimin e gjyqtarit, në tetor 2006, i cili kishte konsistuar në paraqitjen përpara një institucioni bankar, në kuadër të procedurave që gjyqtari po ndiqte për përfitimin e një kredie bankare për strehim me kushte lehtësuese të akorduara atij, të një deklaratë noteriale të përpiluar në mënyrë të njëanshme nga babai i tij. Ky i fundit shfaqet si garantues (hipotekues) i detyrimit të pagimit të kredisë bankare për gjyqtarin, por nga ana tjetër përmes deklaratës synonte të siguronte mbrojtje në raport me të birin, gjyqtarin {...}, në eventualitet të vënies dorë mbi pasurinë e tij, në rast mospagimi të kredisë bankare, dokument ky që sikurse ka rezultuar ka qenë i pavlerë dhe i parëndësishëm për përfitimin e kredisë bankare nga gjyqtari, të cilën gjyqtari do ta përfitonte edhe në rast mosparaqitjeje të deklaratës noteriale. Pas shqyrtimit dhe analizimit të fakteve si dhe pasi dëgjoi gjyqtarin në seancë dëgjimore, Këshilli vlerësoi se ai, gjatë gjithë periudhës së gradimit/periudhës së rivlerësimit, ishte përpjekur të shfaqte një sjellje të kujdesshme, objektive, me vetpërbajtje dhe maturi, përballë të cilës veprimi si më lart nuk duhet të afektonte vlerësimin për angazhimin dhe përgjegjshmërinë e tij në funksion.

Në përputhje me vlerësimin e mesipërm, Këshilli mban në konsideratë edhe qëndrimin e KPK-së, e cila pavarësisht vlerësimeve të saj në pjesën arsyetuese të vendimit, nuk ka evidentuar dhe as ka përcjellë pranë KLGJ-së për shqyrtim shkaqe që duhet të merren parasysh për efekt të

...  
vlerësimit etik dhe profesional, sipas përcaktimeve të nenit 59 pika 4 të Ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Shqipërisë”.

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtari ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e detyrës dhe jashtë saj, prandaj shkalla e etikës së treguar nga gjyqtari në rastin konkret duhet të vlerësohet “shumë e lartë ” duke u pikëzuar me 28 pikë.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

### **3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT**

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e KLGJ-së konkludohet se “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me integritetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm..”.

#### **3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLFJ-së;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton të jenë paraqitur tre ankesa, referuar dhe analizuar në treguesin më sipër, të cilat janë verifikuar nga Inspektorati i KLD-së dhe janë referuar për t’u mbajtur në konsideratë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

...

Nga raporti i ILDKPKI administruar në procesin e rivlerësimit kalimtar, që përkon me periudhën e vlerësimit, konkludohet se gjyqtari nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. Të njëjtin konkluzion ka arritur edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë për gjyqtarin {...}.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

#### KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

#### ***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

### **3.C PAANËSIA E GJYQTARIT**

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së konkludohet se: “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit...asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të tjera të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale, me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.”.

#### **3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***



...

Në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga gjyqtari.

#### KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

### **3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga KLGJ, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se; ”.. në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve.”

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

⋮

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura më short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paañesi në funksion, në mungesë të dhënave për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, konkludohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të jetë i pa konsiderueshëm.

#### KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Për këto arsye, për këtë tregues, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet si i pa konsiderueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, për në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.*

#### ***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”***

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

#### **4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### **4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT**

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së konkludohet se: “..Në 5 dosjet e vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në seancat gjyqësore. Në rastin kur i

⋮

*drejtohet të tretëve me shkresa, komunikimi është i qartë dhe i sjellshëm. Gjuha e përdorur në akteve e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit dhe as kërkesa të vetë gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.”.*

#### **4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimeve shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*institucioneve të paraburgimit, drejtorive të policisë etj, për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve*) në aktet shkresore është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

#### **4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :*

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short nuk rezulton asnjë e dhënë për cënim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit. Në dy çështje në të cilat të pandehurit ose dëshmitarët kanë qenë në moshë të mitur gjyqtari rezulton të ketë respektuar me korrektësi normat procedurale për pjesëmarrjen e tyre në gjykim nën asistencën e mbrojtësit dhe psikologut (vendimi 2, dosja 10) si dhe për të zhvilluar pyetjen e dëshmitarëve të mitur në respektim të rregullave të posaçme procedurale (vendimi 2), duke garantuar mbrojtjen e posaçme të të dhënave personale dhe konfidencialitetit.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

#### ***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR**

⋮

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e KLGJ-së konkludohet se “..Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.”.

#### **4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, pas sjell si pasojë prezumimin se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivelin të lartë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtari me kolegët, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

#### ***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

⋮

#### 4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:*

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga te burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën të bashkëpunimit, passjell si pasojë prezumimin se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera te vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivelin të lartë.

#### KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

⋮

#### **4.C. GATIËSHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA :**

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e KLGJ-së konkludohet se “..Gjyqtari {...} i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës...Të dhënat e Shkollës së Magjistraturës tregojnë se gjyqtari {...} ka qenë pjesëmarrës në 17 seminare trajnimi, me 24 ditë në 3 vjet. Për rrjedhim subjekti i rivlerësimit {...} ka marrë pjesë në 24 ditë trajnimi brenda periudhës së rivlerësimit, duke plotësuar standardin minimal të pjesëmarrjes në formimin vazhdues prej 24 ditësh në 3 vjet, sipas nenit 76 pika 5 të Ligjit për Statusin. Lënda e trajnimeve ku ai ka marrë pjesë ka një lidhje të pjesshme me detyrën e gjyqtarit në fushën e krimeve të rënda. Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit së bashku me formularin e vetëdeklarimit...ai deklaroi se është angazhuar me kohë të pjesshme si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në periudhën tetor 2013-aktualisht. Gjithashtu ai ka qenë ekspert dhe lehtësues në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në periudhën maj 2014- aktualisht. Ai ka përfunduar studimet pas universitare në Shkollën e Studimeve Evropiane, dega “Legjislacion dhe Institucione Evropiane”, pranë U.T dhe në përfundim ka marrë titullin “Master i nivelit të dytë” (Master shkencor). Rezulton se në vitin 2011-2012 është pranuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, si kandidat në Programin e Studimeve të Doktoraturës...aktualisht është në procesin e shkrimit të disertacionit me temë “Akuzat e reja në procesin penal”. Gjyqtari {...} ka marrë pjesë edhe në dy aktivitete të tjera profesionale jashtë programit të Sh.M. Lënda e trajnimeve ku ai ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të Gjykatës për Krime të Rënda...Këto të dhëna tregojnë se ai ka qenë shumë i gatshëm për t’u angazhuar në aktivitete profesionale.”.

#### **4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, vërtetimit me nr. 398/1 prot, datë 13.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëdeklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ai ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit, lehtësuesit dhe pjesëmarrësit.

...

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr. 398/1 prot datë 13.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e ekspertit në 4 aktivitete trajnuese, gjithsej 7 ditë; në cilësinë e lehtësuesit në 1 aktivitet trajnues, gjithsej 2 ditë; në cilësinë e pjesëmarrësit në 20 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 33 ditë.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9<sup>19</sup> të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e trajnerit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si trajner e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës tre vjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 54.5 ditë në gjithë periudhën e vlerësimit.

Gjithashtu, pas administrimit të provave të reja në seancë dëgjimore, rezultoi se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete të tjera profesionale, jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës si më poshtë:

- Konferenca shkencore ndërkombëtare “Forcimi i institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë”, organizuar nga OSBE, më datë 24 qershor 2014;
- Aktiviteti me temë “Gjykimi i çështjeve të terrorizmit dhe sigurisë kombëtare”, organizuar nga CEELI në Pragë, Çeki, në datat 14-15 qershor 2016;
- Konferenca shkencore ndërkombëtare me temë “Përafrimi i legjislacionit shqiptar me EU Acquis, perspektivat dhe sfidat”, organizuar nga Ministria e Ministria e Integritit Europian në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, me mbështetjen e SMEI-3.
- Konferencë shkencore ndërkombëtare me temë “Ligji penal dhe zbatimi i tij”, Tiranë 2014.
- Konferenca shkencore ndërkombëtare me temë “Forcimi i institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë”,
- Konferencës shkencore ndërkombëtare me temë “Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, Maj 2016.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës drejtës penale

<sup>19</sup>Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se: “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.



dhe procedurale penale, hetimit pasuror, pastrimit të produkteve të veprës penale, terrorizmit etj, me një kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

***Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh.M dhe trajnime të tjera profesionale është nga 15-120 ditë duke u pikëzuar me 20 pikë.*

#### **4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëdeklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtari, rezulton se ai është angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit në 4 aktivitete trajnuese, gjithsej 7 ditë dhe në cilësinë e lehtësuesit në 1 aktivitet trajnues, gjithsej 2 ditë.

Lidhur me gatishmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e ekspertit dhe lehtësuesit në disa aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues ndërkohë që nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

.....

***Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, për treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

#### **4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Në formularin e vetëdeklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, është referuar për angazhimin e tij në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo veprimtari të tjera të tilla si pjesëmarrje në konferenca shkencore, mësimdhënie, etj. Nga provat e reja të administruara në seancë dëgjimore, rezulton angazhimi i gjyqtarit në konferenca ndërkombëtare, ku ai ka referuar tema që nuk tregojnë vetëm rritjen e tij profesionale, por synojnë përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Gjithashtu, referuar vërtetimit me nr. 76 prot, datë 23.9.2017, të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, rezulton angazhimi i gjyqtarit në cilësinë e pedagogut të jashtëm pranë Departamentit të së Drejtës Penale për vitet akademike 2011-2017, duke përfshirë edhe periudhën e vlerësimit 2013- 2016.

Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë të gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike, e cila duhet të synojë përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Prandaj angazhimi i gjyqtarit në cilësinë e pedagogut të jashtëm pranë Departamentit të së Drejtës Penale dhe referimi i tij në 4 Konferenca Shkencore Ndërkombëtare, janë tregues i përpjekjeve të vazhdueshme të gjyqtarit për të dhënë kontribut në përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

...

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, referuar shtrirjes ndërkombëtare të angazhimit, shkallës së pjesëmarrjes dhe ndikimit në veprimtarinë specifike, për gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

#### KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndër institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, për treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.*

#### 4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar formularit të vetëdeklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtari dhe akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit e dosjen personale të gjyqtarit, nuk rezultonin të dhëna që tregonin kryerjen nga gjyqtari të publikimeve ligjore akademike.

Gjyqtari {...}, pas njohjes me projektraportin e vlerësimit, paraqiti bashkë me kundërshtimet e tij disa prova që tregonin kontributin e tij në fushën e publikimeve ligjore. Nga vlerësimi i këtyre provave të administruara në seancë dëgjimore, rezultonte se gjatë periudhës së rivlerësimit, gjyqtari kishte realizuar publikimet ligjore si më poshtë :

1. Botim në Revistën studimore shkencore të Qendrës Kërkimore Zhvillimore Peja, Buletini Shkencor nr.1, me ISSN 1800-9794, Nëntor 2014, artikulli me temë “Reforma ligjore shqiptare dhe integrimi europian”, faqe 517-525, në bashkautorësi me znj. Lirime Çukaj.
2. Botim në Revistën “Mediterranean Journal of Social Sciences” vol 7, Maj 2016, me temë “Gjykimi i shkurtuar”, faqe 235-239, me ISSN 2039-2117.

KONKLUZIONI

Pavarësisht se janë vetëm dy botime, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, tipologjise dhe impaktit të botimeve shkencore, për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

**Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi.**

Referuar sa më sipër, për treguesin “publikime ligjore akademike” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

**Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”**

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	100	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	396	Shkëlqyeshëm